



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Matematikë Informatikë”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë, Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**


1. Prof. Asoc. Eralda GJIKA (Dhamo)

2. Prof. Asoc. Dafina XHAKO

Mars/2022


**RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**  
**Për Programin e studimit Bachelor në “Matematikë-Informatikë” ofruar nga**  
**Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Matematikës dhe Fizikës
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “ Matematikë - Informatikë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 833, datë 04.06.2008
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr.323, datë 2017.06.05
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/ 6 Semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	17 PAE/ 5 PAK v.a. 2018-2019 18 PAE/ 2 PAK v.a. 2019-2020 18 PAE/ 2 PAK v.a. 2020-2021
18	Numri i studentëve:	v.a. 2018-2019 24 Studentë v.a. 2019-2020 7 Studentë v.a. 2020-2021 14 Studentë
19	Komente / të tjera:	

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në Matematikë-Informatikë ofruar nga Universiteti Fan S. Noli, është hapur me VKM Nr. 833, datë 04.06.2008. Njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Matematikës dhe Fizikës në Fakultetin e Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane. Hapja e këtij programi studimi është mbështetur tërësisht në kuadrin ligjor për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. Si model për programin mësimor janë shfrytëzuar eksperiencat dhe përvojat edhe të universiteteve të tjera publike vendore dhe rajonale. Ndryshimet e kryera janë bërë duke u mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi (VKM nr. 41, datë 24.01.2018). Programi i studimit është i organizuar në module lëndore të cilat kanë peshën e tyre shprehur në kredite ECTS. Në total programi ka 180 kredite ECTS. Qëllimi i këtij programi studimi siç theksohet edhe në RVB është *rritja e kompetencave shkencore e profesionale të studentëve, formimin e etikës, njohjen e legjislacionit dhe përfitimin e shprehive praktike për të qenë të aftë në kryerjen e detyrave të ndryshme, qoftë teorike apo me karakter aplikativ*. Departamenti i Matematikës dhe Fizikës, si njësia bazë për ofrimin e këtij programi studimi ka në organikën e vet një staf akademik prej 17 pedagogësh, nga të cilët 12 të brendshëm dhe 5 të jashtëm.




## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit Bachelor në “Matematikë-Informatikë” filloi me prezantimin e dokumentacionit të paraqitur nga IAL dhe organizimin e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm në lidhje me shqyrtimin e dokumentacionit dhe përgatitjen e raportit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga ASCAL, filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj procedure u identifikuan dhe u listuan pyetje në lidhje me standarde dhe kritere përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në Universitetin Fan S. Noli, Korçë, u realizua gjatë datave 08-09.11.2021, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shoqëruar nga koordinatori teknik i ASCAL, i caktuar për këtë program studimi, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me Rektorin, Dekanin e Fakultetit dhe Përgjegjësen e Departamentit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, pedagogët dhe studentët e këtij programi studimi si dhe vizitoi zyra të caktuara të këtij institucioni dhe mjediset e tij. Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe çështje për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.

Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Koordinatorin Teknik i ASCAL.

Me datw 16.02.2022, Departamenti i Matematikës dhe Fizikës pranw Universitetit “Fan S. Noli”, Korçë shprehu dakordwsinw e tij me Draft Raportit e dwrguar 14.02.2022 dhe nuk ka asnjw koment. Raporti merr formw finale.



**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Matematikë-Informatikë”**

**I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR**

<b>Standardi I.1</b>				
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Universiteti “Fan S. Noli” ofron ndër shumë programe të tjera edhe programin e studimit, “Matematikë – Informatikë” që është pjesë e këtij vlerësimi të jashtëm, dhe nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Ky program është në përputhje me interesat dhe zhvillimin e vendit referuar VKM-së nr. 514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve”. [Aneks II.01.1]			
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi i studimit bachelor “Matematikë-Informatikë”, i ofruar nga Universiteti “Fan S. Noli” është në përputhje me interesat kombëtare dhe synon përgatitjen e mësuesve në disiplinat e matematikës dhe informatikës duke promovuar njohuritë shkencore nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në shërbim të zhvillimit kombëtar dhe rajonal. Ky program studimi gjithashtu në dokumentacionin e paraqitur tregon se është i orientuar në ruajtjen, konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare të sanksionuara gjithashtu në Statutin e UNIKO.			
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit “Matematikë-Informatikë” është hartuar dhe ofrohet në përputhje me qëllimin, misionin dhe planin Strategjik të Zhvillimit të Universitetit “Fan S. Noli” [Aneks I.03]. Programi synon përgatitjen e specialistëve të ardhshëm në fushën e Matematikës, Informatikës dhe Fizikës, specialistëve të lartë dhe shkencëtarëve të rinj, në përputhje me prioritetet e zhvillimit të vendit dhe rajonit që mbulon.			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	Programi “Matematikë-Informatikë” i ofruar nga Universiteti “Fan S. Noli” është hartuar për të ofruar një mjedis mësimor dhe shkencor bashkëpunues për zhvillimin e dijeve nëpërmjet mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ky program është ndër programet kryesore të kësaj discipline që ofron sigurimin e vazhueshëm për mësues për ciklin e ulët dhe të mesëm në profilet Matematikë, Informatikë, për rajonin por edhe në nivel kombëtar. Kurrikula e ofruar është e përshtatshme për të siguruar përvetësimin e kompetencave profesionale dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal/kombëtar. (Aneksi II.07.2)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Standardi I.2**

<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>				
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>			
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Referuar planit Strategjik të Zhvillimit të Universitetit "Fan S. Noli" [ <i>Aneks I.03</i> ], programi i studimit "Matematikë-Informatikë" reflekton qartë parimet mbi të cilat është hartuar dhe bazuar qëllimi, misioni dhe strategjia e zhvillimit të vetë institucionit. Referuar statutit të Universiteti "Fan S. Noli" [ <i>Aneks I.01 Statuti i UK, Kreu I, Neni 2, Pika (1)</i> ], misioni i tij është të përgatisë profesionalisht specialistë të lartë në fushat që mbulon në të gjitha programet e studimit, nëpërmjet mësimdhënies dhe praktikave profesionale. Edhe programi i studimit "Matematikë-Informatikë" hartuar nga Departamenti i Matematikës dhe Fizikës, të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane, janë miratuar nga Senati Akademik i Universitetit në përputhje të plotë me drejtimit dhe misionin që synon Universiteti "Fan S. Noli" [ <i>Aneks I.01 Statuti i Universitetit "Fan S. Noli" - Kreu VI, Neni 47, Pika (3) dhe Aneks I.02 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore Shkencore e Universitetit "Fan S. Noli"- Kreu VI, Neni 56, Pika (3)</i> ],			
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Referuar Statutit të Universitetit "Fan S. Noli", [ <i>Kreu VI, Neni 47, Pika (7), Aneks I.01</i> ] dhe Rregullores së tij [ <i>Kreu VI, Neni 56, Pika (7), Aneks I.02</i> ], emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit "Matematikë- Informatikë" ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademike të parashikuara në to, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe punësimin e ardhshëm të studentëve. Gjithashtu, Departamenti i Matematikës dhe Fizikës, në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit mbulon të gjitha lëndët/modulet e profilit të matematikës dhe fizikës në programet e tjera të studimit që ofron Universitetit "Fan S. Noli".			
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Referuar Statutit të Universitetit "Fan S. Noli", [ <i>Kreu VI, Neni 47, Pika (7), Aneks I.01</i> ] dhe Rregullores së tij [ <i>Kreu VI, Neni 56, Pika (7), Aneks I.02</i> ], emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit të studimit "Matematikë- Informatikë" ofrohet në përputhje me fushat e drejtimit akademike të parashikuara në to, në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe punësimin e ardhshëm të studentëve. Gjithashtu, Departamenti i Matematikës dhe Fizikës, në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit mbulon të gjitha lëndët/modulet e profilit të matematikës dhe fizikës në programet e tjera të studimit që ofron Universitetit "Fan S. Noli".			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.3</b>	
<b>Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që	Programi i studimit të ciklit të parë "Matematikë – Informatikë është hartuar në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të institucionit dhe ka objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këtë program referuar Rregullores së Programit të Studimit "Matematikë-Informatikë", seksionet 3 dhe 4 [ <i>Aneks II.05 MI</i> ]. Konkretisht programi i studimit "Matematikë –Informatikë", synon të përgatisë studentë që: - Të kenë përvetësuar njohuritë bazë dhe të thelluara të matematikës dhe informatikës.

<p>karakterizojnë profilin e programit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të kenë përvetësuar njohuritë bazë të fizikës si pjesë plotësuese e kurrikulës.</li> <li>- Zbatojnë praktikisht njohuritë teorike të përftuara duke punuar në projekte individuale ose në grup.</li> </ul>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Në fakt gjatë takimit me Grupin e vlerësimit të brendshëm, përgjegjës in e departamentit dhe me vetë stafin të angazhuar në këto programe studimi u diskutua gjatë mbi këtë pikë. Vetë institucioni nuk kishte kryer ndonjë studim të mirëfilltë paraprak të tregut të punës përpara hapjes së programeve dhe në vijim këto studime janë të vakëta. Nga diskutimet e bëra rezultoi se domosdoshmëria e hapjes së këtyre programeve lindi si nevojë e zonës së Korçës për mësues të matematikës, fizikës dhe informatikës. Ky përfundim u arrit nga komunikimet e vazhdueshme me zyrat e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë dhe vetë Universitetit “Fan S. Noli”. Departamenti i Matematikës dhe Fizikës ka kryer më herët një monitorim mbi ecurinë e numrit të nxënësve në shkollat 9-vjeçare dhe gjimnazet e qarkut Korçë, tendencën në shifra për të paktën 6 vitet e fundit dhe si është reflektuar kjo tek numri i të regjistruarve në të dy programet studimit në fjalë (të dhënat janë marrë nga zyrat e Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë dhe ky studim gjendet në [Aneks III.12]). Në këtë studim vihet re se një pjesë e konsiderueshme e studentëve që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve në një prej dy programeve që ofron departamenti janë punësuar si mësues në rajon.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësve, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Qendra e Karrierës dhe Alumnit në Universitetin “Fan S. Noli” përditëson informacionin mbi të dhënat e studentëve dhe punëdhënësve. Kjo qendër funksionon dhe plotëson objektivat e saj në orientimin e studentëve në tregun e punës si dhe ndërveprimin të studentëve të diplomuar dhe studentëve aktualë, duke i orientuar këta të fundit drejt përvojave dhe jetës profesionale [Aneks III.20]. Kjo qendër nxit dhe mbështet pjesëmarrjen e studentëve në panairin e punës, që organizohet çdo vit nga Bashkia e qytetit të Korçës.</p> <p>Referuar kurrikulës dhe programeve lëndore [Aneks II.07.2 MI2020-2021], të hartuara me qëllim për të formuar në mënyrë të plotë një mësues apo specialist në profilet Matematikë, Informatikë si dhe përditësimit të tyre nga stafi i angazhuar në këtë program studimi, programi i studimit “Matematikë-Informatikë” garanton përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive dhe kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut të punës. Ajo që vihet re dhe ka vënd për përmirësim është lehtësimi sado pak i studentëve nga modulet e shumta dhe grupimi i tyre në një numër më të vogël lëndësh.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

**Standardi I.4**

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Në nivel institucional vihet re se Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane (FSHNH), ku ofrohet ky program studimi, synon të përmirësojë vazhdimisht kushtet duke përfshirë këtu kapacitetet e duhura për ofrimin e programit të studimit. Fakulteti përbëhet nga 3 departamente në përputhje me ligjin e arsimit të lartë. <i>[Shtojca 1.1], [Aneksi IV]</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Matematikë-Informatikë” ofrohet nga një staf i mirëkualifikuar, të cilët kanë eksperiencën e nevojshme për të mbuluar lëndët e programit të studimit. Gjithashtu përgatitja e stafit është në përputhje të plotë me fushën akademike dhe kërkimore të Departamentit, si dhe me modulet që mbulohen prej tyre. Ky staf si rezultat i bashkëpunimeve me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare tregon përpjekje për kualifikim të vazhdueshëm. <i>[Aneksi IV.02], (Aneksi II.09).</i></p> <p>Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit “Matematikë-Informatikë” është Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane (FSHNH). Ky program ofrohet nga Departamenti i Matematikës dhe Fizikës i vendosur pranë FSHNH i riorganizuar në bazë të Urdhërit nr. 16, datë 17.01.2012 të Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës <i>[Aneksi II.01.2]</i>. Ky program është program studimi i ciklit të parë, referuar nivelit 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimit, të organizuar me 180 kredite (ECTS) dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademike, përkatësisht 60 ECTS në çdo vit akademik në përputhje me Ligjin 80/15, Neni 73, Pika (1). Si pjesë e FSHNH ai është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të këtij fakulteti.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit “Matematikë-Informatikë” ofrohet brenda profilit dhe ekspertizës së njësisë kryesore dhe asaj bazë <i>[Rregullore e Brendshme e FSHNH, Kreu II, Neni 6]</i>.</p> <p>Veprimtaria formuese e programit të studimit Bachelor në “Matematikë-Informatikë” është organizuar në disa veprimtari kryesore: veprimtari të formimit bazë, veprimtari karakterizuese, disiplina ndërdisiplinore/integruese, veprimtari plotësuese (dhe detyrime përmblylëse (përgatitje e tezës së diplomës ose provim formimi), në respektim të shpërndarjes në përqindje të secilit grup të disiplinave të formimit dhe i përcaktimit të krediteve.</p> <p>Departamenti i Matematikës dhe Fizikës është njësi bazë, përgjegjëse për programin e studimit “Matematikë-Informatikë”. Referuar të dhënave mbi stafin e saj <i>[Aneksi IV]</i> kjo njësi ka në përbërjen e saj staf me një përvojë relativisht të gjatë në fushën e mësimdhënies në profilet e matematikës dhe fizikës. Aktualisht pjesë e këtij departamenti janë: 1 profesor, 6 doktorë shkencash, 1 doktor në proces (në pritje të mbrojtjes së doktoraturës) dhe 4 master shkencash. Modulet</p>



	<p>specifike të fushës së informatikës mbulohen nga stafi i Departamentit të Informatikës. Vihet re që pjesë e stafit akademik me kohë të pjesëshme janë emra të shquar dhe me eksperience dhjetra vjecare në profilin dhe lëndët specifike që japin.</p> <p>Programi është në linjë me synimet dhe misionin e UK, si dhe emërtimi i programit të studimit, është i njëjtë me emërtimin e vetë Departamentit. [Aneksi II.05]</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Përgjegjësitë për marrëdhëniet e bashkëpunimit brenda institucionit janë të përcaktuara në Statutin dhe Rregulloren brenda institucionit (UNIKO). Ky institucion përbën një IAL të mirëorganizuar midis njërive bazë njërive kryesore si dhe brenda tyre. Këtë organizim e reflekton: ndarja midis fakulteteve dhe marrëdhëniet brenda tyre; si dhe delegimi dhe përcjellja e procedurave, analizave vjetore të duaneshme. [Shtojca 1.1]. Hartimi, administrimi dhe mbarëvajtja e programit të studimit “Matematikë-Informatikë” bazohen tek Statuti dhe Rregullorja e UNIKO (Aneksi I.01 dhe Aneksi I.02), si dhe në Rregulloren e Brendshme të FSHNH (Aneks II.02), të cilat janë hartuar në mbështetje të Ligjit 80/2015. Në mbështetje të këtij dokumentacioni përcaktohet ndarja e detyrave dhe përgjegjësive midis strukturave, ku peshën kryesore për programin e studimit e ka njësia bazë (Aneksi I.02 - Rregullore e UNIKO, Kreu II, Neni 5). Këtu është bërë një përcaktim i detajuar i rolit të drejtuesit të njësisë bazë (Aneksi I.02 - Rregullore e UNIKO, Kreu III, Neni 20) dhe detyrave dhe përgjegjësive të personelit akademik (Aneksi I.02 - Rregullore e UNIKO, Kreu V, Neni 33). Gjithashtu, Kreu III, Neni 22 të rregullores janë të përcaktuara qartë elementët përbërës të raportimit për veprimtaritë e kryera nga çdo njësi në UNIKO dhe strukturat përgjegjëse për to. Dokumenta të tjera që tregojnë marrjen e përgjegjësive respektive dhe analizën e punës janë vendimet e Senatit, vendimet e Rektoratit dhe vendimet e Dekanatit.
<b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ ose të huaj.	Referuar takimit me Qendrën e Karrierës dhe Alumni dhe Qendrën Rinore dhe Sportive si dhe dokumentacionit (Aneks II.10) UNIKO ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe nga të cilat institucioni dhe departamenti po përfiton në drejtim të shkëmbimit të përvojës, kërkimit shkencor, ristrukturimit të programeve të studimit, përditësimit të kurrikulës, organizimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe kryerjes e praktikave profesionale sidomos për ato programe studimi kurrikula e të cilave përfshijn praktikat specifike profesionale. Programi
<b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës,	

në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	i studimit Bachelor në “Matematikë-Informatikë” nuk ofron praktika profesionale.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Kurrikula e programit të studimit “Matematikë-Informatikë” nuk përfshihin praktika specifike profesionale por ajo është një bazë për studimet e thelluara në ciklin e dytë të studimeve pranë institucionit: Master profesional në fushën e mësuesisë apo Master Shkencor për drejtimet specifike Matematikë, Informatikë ky proces ndiqet në nivelet e masterit. Gjithashtu nuk disponohen marrëveshje për trajnime profesionale për studentët e diplomuar por nga takimet e zhvilluara sipas axhendës rezultojnë se qendra e formimit të vazhduar në UNIKO, ofron dy module të akredituara për trajnimin e mësuesve nga të cilat mund të përfitojnë studentët e diplomuar. Konkretisht: “Mësimdhënia e Matematikës në Ciklin e Ulët” dhe “Krijimi i situatave problemore në mësimdhënien e Fizikës” situatave problemore në dhënien e Fizikës”			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b> <b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Sipas dokumentacionit (shiko në fund të paragrafit) të paraqitur nga departamenti programi i studimit “Matematikë-Informatikë” është organizuar në lëndë dhe module të vlerësuara në total me 180 kredite (ECTS). Kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në përputhje me Ligjin 80/15, Neni 70 dhe Neni 73. Ky program është organizuar në disiplina të vlerësuara me kredite, në përputhje me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Matematikë-informatikë” realizohet në 3 vite studimi/6 semestra, me 30 kredite çdo semester. Programi i studimit ka të kombinuara lëndët e modulet përbërëse të tyre në forma të detyrueshme dhe me zgjedhje për studentin. Të detajuara për të gjithë periudhën në shqyrtim ky
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një	

llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.	dokumentacion gjendet në: ( <b>Aneks II.07.2 MI2018-2019, Aneks II.07.2 MI2019-2020, Aneks II.07.2 MI2020-2021</b> )
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuar në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.	Kurrikula e programit të studimit “Matematikë-Informatikë” për tre vite; <b>Aneks II.07.2 ;II.07 MI2018-2019, Aneks II.07 MI2019-2020, Aneks II.07 MI2020-2021</b> - Planet mësimore të programeve të studimit “Matematikë-Informatikë” për tre vite pasqyrohen disiplinat mësimore, raporti teori/seminare (ushtrime)/seanca laboratorike, numri i krediteve për secilën disiplinë si dhe detyrimet akademike për çdo disiplinë.
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	Duke iu referuar anekseve bashkangjitur si dhe takimeve të zhvilluara pranë institucionit (takimi me përfaqësuesin e departamentit, stafin akademik si dhe përfaqësues të njësisë kryesore dhe universitetit) del në pah se programi i studimit “Matematikë-Informatikë” si program i profilit mësuesi ka për qëllim të pajisë studentët me njohuri bazë dhe të thelluara në tre disiplina kryesore: matematikë, informatikë dhe fizikë. Nga takimi me përfaqësues të njësisë bazë dhe njësisë kryesore u përmend se nevojat e tregut të punës për mësues dhe specialistë me njohuri në matematikë, informatikë dhe fizikë në rajon por jo vetëm kanë qënë një ndër arsytet e hartimit të këtij programi.
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	Dokumentacioni i paraqitur tregon qartë këto synime dhe arritje të departamentit. ( <b>Aneks II.07.2 MI2018-2019, Aneks II.07.2 MI2019-2020, Aneks II.07.2 MI2020-2021</b> –Kurrikula e programit të studimit “Matematikë-Informatikë” për tre vite; janë hartuar në përputhje me nevojat e profileve dhe ristrukturuar në përshtatje me modelet e programeve homologe, kërkesat e tregut, si dhe kornizën e kompetencave bashkëkohore.
<b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Nga analizimi i kurrikulës vihet re se ajo përfshin module të kategorisë bazë, karakterizuese, integruese, plotësuese dhe përmbyllëse. Modulet karakterizuese dhe integruese ofrojnë për studentët formim specifik dhe njohuri të fushës kryesore dhe këto njohuri plotësohen me njohuri të përgjithshme në fushën e grup-lëndëve që ofrohen nga departamenti. Programet e studimit nga larmishmëria dhe organizimi tregojnë se i krijojnë studentit hapësirën për thellimin e dijeve në disiplinë ku ai shpreh interes. Programi ofron disa module me zgjedhje të cilat i ofrojnë mundësi studentit të përfitojë njohuri të përparuar në fushën e studimit dhe/ose punësim. (dokumentacioni mbi kurrikulat <b>Aneks II.07.2 MI2020-2021</b> )  Gjatë konsultimit të dokumentacionit mbështetës por edhe takimit me përgjegjës të departamentit dhe stafin akademik të tij u vu re se: kurrikula e programit të studimit “Matematikë-Informatikë” zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca duke filluar nga ato bazë dhe të avancuara në fushën akademike dhe profesionale. Kurrikulat janë të organizuara në module të kategorisë: <i>bazë, karakterizuese, integruese, plotësuese dhe përmbyllëse.</i> Modulet karakterizuese dhe integruese ofrojnë për studentët formim specifik dhe njohuri të fushës në profesionet mësuesi apo edhe specialistë në disiplinat e matematikës, informatikës edhe fizikës.


	<p>Studenti ka të drejtë të zgjedhë një numër modulesh (lëndë me zgjedhje), sipas përcaktimeve në kurrikulat përkatëse (<b>Aneks II.07.2 MI2020-2021 dhe Aneks II.07.2 MF2020-2021</b>). Programi i studimeve synon t'u ofrojnë studentëve kurrikula, metodologji, literaturë dhe infrastrukturë të tillë që të mund të përshtaten në tregun e punës dhe të mund të vazhdojnë studime të mëtejshme në institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit në disiplina të ngjashme me atë të ofruar nga programi.</p> <p>Referuar dokumentacionit të bashkëngjitur në aplikim u vu re se programi i studimit “Matematikë-Informatikë” përmban të gjithë elementët e strukturës së kërkuar të një programi studimi, në përputhje me VKM Nr. 41 datë 24.01.2018, Pika (2), përfshirë këtu: Kreditet, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Planet mësimore (<b>Aneks II.07 MI2018-2019, Aneks II.07 MI2019-2020, Aneks II.07 MI2020-2021</b>).</p> <p>Kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit, të cilat janë të pasqyruara hollësisht në Rregulloren e Brendshme e FSHNH, Kreu IV (<b>Aneks II.02</b>); Rregulloret e programeve të studimit, seksionet 13 dhe 14 (<b>Aneks II.05 MI</b>) dhe programet lëndore (<b>Aneks II.08 MI2018-2019, Aneks II.08 MI2019-2020, Aneks II.08 MI2020-2021</b>) Programet lëndore të programit të studimit “Matematikë-Informatikë” për tre vite; të çdo lënde/moduli.</p> <p>Objektivat formuese dhe kompetencat të pasqyruara në Rregulloret e programeve të studimit, seksionet 3 dhe 4 (<b>Aneks II.05 MI</b>) Komponentët mësimorë ndahen në leksione, seminare/ushtime, dhe orë laboratorit, që zhvillohen respektivisht në auditorë dhe laboratorët e Departamentiit. Kategorizimi i veprimtarive formuese dhe pesha që zë secila kategori në programet e studimit “Matematikë-Informatikë” është realizuar në përshtatje me VKM Nr. 41, Shtojca Nr. 1, Tabela 1 (<b>Aneks II.07.1</b>).</p> <p>Të gjithë elementët e sipërpërmendur janë të pasqyruar tek Rregulloret përkatëse të programit të studimit (<b>Aneks II.05 MI</b>) Referuar (<b>Aneks II.07.1</b>) vihet re se programi i studimit përmban të gjitha elementët e strukturës së kërkuar prej Udhëzimit Nr. 41 të MASR, dt. 24.01.2018 për “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL” Në planet mësimore dhe programet lëndore (syllabus) specifikohet kategoria e veprimtarisë formuese, në të cilën klasifikohet moduli dhe të tjera informacione të rëndësishme për justifikimin e ngarkesës përkatëse në kredite.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

<b>Standardi II.2</b> <b>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Duke shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur në dosjen e aplikimit rezulton se UNIKO është institucion i akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 65, datë 21/09/2017(Aneks II.01.3). Departamenti i Matematikës dhe Fizikës është njësi bazë e FSHNH në UNIKO, që ofron programin e studimit Bachelor në "Matematikë-Informatikë". Ky departament përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin, sipas përcaktimeve në Ligjin 80/2015, Neni 106, Pikat (3), (4), vendimit të rektoratit dhe axhendës së miratuar nga ASCAL, për akreditimin e programeve të studimit në UNIKO (Aneks III.02 dhe Aneks III.02.1).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Nga dokumentacioni bashkëngjitur dhe diskutimeve në takimin e organizuar me departamentin dhe drejtuesin e tij rezultoi se: koordinatori i programit të studimit "Matematikë-Informatikë (Aneks II.11), është aktiv dhe luan një rol të rëndësishëm në drejtim të zhvillimit dhe rritjes të cilësisë të programit të studimit. Midis Koordinatorit të programit dhe Drejtuesit të Departamentit ekziston një bashkëpunim i vazhdueshëm, në ndihmë të vendimmarrjes për ecurinë dhe zhvillimin e programit. Detyrat e koordinatorit të programit të studimit janë të specifikuar në Rregulloren e Brendshme të FSHNH, Kreu II, Neni 14 (Aneks II.02)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>FSHNH përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik në përputhje me përcaktimet ligjore të Ligjit Nr. 80/2015 për "Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë". Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit "Matematikë-Informatikë" është Departamenti i Matematikës dhe Fizikës i cili është pjesë e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane. Ky fakultet përbëhet nga pesë departamente (Aneks II.02 - Rregullore e Brendshme e FSHNH, Kreu II, Neni 6) dhe 49 anëtarë të personelit akademik: 2 profesorë, 26 doktorë shkencash prej të cilëve 2 PHD, 1 docent, 6 studentë doktore dhe 14 M.Sc (Aneks II.13 - Personeli akademik dhe ndihmës akademik i FSHNH). Në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Kreu III, Neni 23, ofron studime me kohë të plotë, në programe profesionale dy vjeçare, programe studimi të ciklit të parë (Bachelor) dhe të ciklit të dytë (Master profesional dhe Master i Shkencave) (Aneks II.02 -Rregullore e Brendshme e FSHNH, Kreu III, Neni 24, 25, 26,27)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Departamenti i Matematikës dhe Fizikës, si pjesë e FSHNH, është organizuar dhe ushtron kompetenca të plota mbi mbarëvajtjen e aspektit mësimor dhe kërkimor-shkencor duke respektuar rigorozisht të gjitha detyrimet që burojnë prej akteve ligjore dhe nënligjore, Statutit të UK (Aneks I.01), Rregullores të UK (Aneks I.02), Rregullores të Brendshme të FSHNH (Aneks II.02) dhe Rregulloreve të programeve të studimit studimit "Matematikë- Informatikë" (Aneks II.05MI).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Matematikës dhe Fizikës, si pjesë e FSHNH, është organizuar dhe ushtron kompetenca të plota mbi mbarëvajtjen e aspektit mësimor dhe kërkimor-shkencor duke respektuar rigorozisht të gjitha detyrimet që burojnë prej akteve ligjore dhe nënligjore, Statutit të UK (Aneks I.01), Rregullores të UK (Aneks I.02), Rregullores të Brendshme të FSHNH (Aneks II.02) dhe Rregulloreve të programeve të studimit studimit "Matematikë- Informatikë" (Aneks II.05MI).</p>

	<p>Në përputhje me ligjin në fuqi (L. 80/2015 - Neni 22, pika 3, Neni 25, pika 1) njësia bazë përgjegjëse për këtë program studimi, është Departamenti i Matematikës dhe Fizikës.</p> <p>Personeli i departamentit përbëhet nga personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik (L. 80/2015 - Neni 57, pika 1).</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021, Departamenti i Matematikës dhe Fizikës përbëhet nga 12 staf akademik me kohë të plotë, me kualifikimin si vijon, 1 Prof; 6 Dr dhe 5 Msc dhe 5 staf akademik me kohë të pjesshme, me kualifikimin, 3 Prof; 1 Prof As; 1 Msc.</p> <p><b>(Aneksi IV, Tabela 1)</b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi II.3</b>	
<b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia bazë përgjegjëse për organizimin e programit të studimit disponon dokumentacionin e plotë për këtë program studimi ku përfshihen: Kurrikulat e programit të studimit për periudhën 3 vjeçare ( <b>Aneksi II.07.2</b> ); Plani mësimor ( <b>Aneksi II.07</b> ); Klasifikimi i lëndëve sipas përcaktimeve ligjore në fuqi ( <b>Aneksi II.02</b> ) si dhe Syllabuset e lëndëve.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	Kurrikula e këtij programi studimi është ndërtuar në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi (VKM nr.41 dt. 24/01/2018). Në të pasqyrohen objektiva formues dhe kompetenca profesionale përcaktuese dhe specifike që duhet të ofrojë programi i studimit. Kurrikula është e organizuar në 41 lëndë (organizuar në veprimtari formuese, bazë, karakterizuese, plotësuese dhe përmblylëse si tema e diplomës). ( <b>Aneksi II.05</b> ), ( <b>Aneksi II.07</b> )
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Referuar dokumentacionit shoqërues ( <b>Aneks II.07 MI2020-2021 ; dhe Aneks II.08 MI2020-2021</b> ) ku gjenden planet mësimore të programit të studimit "Matematikë- Informatikë" programet lëndore përkatëse paraqiten qartë elementët e mëposhtëm:
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Struktura në javë, për çdo vit të ciklit të studimit dhe semestër (javë mësimi, praktikë profesionale, provime dhe diplomë)</li> <li>• Lëndët e specifikuar sipas kategorive të veprimtarive formuese.</li> <li>• Frekuentimi (lëndë e detyruar/lëndë me zgjedhje)</li> <li>• Specifikime të vitit dhe semestrit ku zhvillohet lënda.</li> <li>• Numri i krediteve për çdo lëndë dhe ngarkesa e orëve në auditor dhe orëve jashtë auditorit.</li> </ul>

**Kriteri 5.** Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.

**Kriteri 6.** Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.

**Kriteri 7.** Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.

- Ndarja e orëve mësimore në auditor në orë për leksione, seminare, ushtrime, laboratore, detyrë/projekt kursi, përkon me natyrën e lëndës.
- Periudha dhe mënyra e kontrollit të dijeve të çdo lënde (semestri, provimi).

Sipas dokumentacionin bashkëngjitur (**Aneks II.12**) planet mësimore përditësohen çdo vit akademik dhe miratohen nga Senati i UNIKO DMF, në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga Rregullore e Brendshme e FSHNH, Kreu III, Neni 35, (**Aneks II.02**). Në fund të çdo viti akademik kryhen modifikimet për planin mësimor për vitin e ardhshëm dhe me miratimin e tyre ato i bëhen të njohura studentëve që në fillim të studimeve dhe publikohen në faqen web të UNIKO, kategoria Programe Studimi. *(Një detaj i rëndësishëm këtu është problematika e aksesimit të faqes zyrtare web të UNIKO).*

Gjithashtu në planet mësimore të prezantuara për periudhën në shqyrtim nuk janë vënë re ndryshime të rëndësishme. Zhvillimi i metodologjive dhe teknologjisë, mund të jenë nxitje për të ri-vlerësuar këto pika.

Nga takimi i realizuar me personelin akademik që japin mësim në këtë program studimi u informuam se çdo fillim viti, por edhe gjatë vitit, diskutohet dhe bëhen përditësime apo rifreskime në programet e lëndëve duke përfshirë në to informacione mbi zhvillimet më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit, vlen të përmendim këtu vendosjen në dispozicion të studentëve të rasteve të studimit më të fundit. Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se këto ndryshime, sidomos referuar pjesës praktike të realizuar gjatë seminarit, duhet të pasqyrohen edhe në syllabuset e lëndëve.

Nga dokumentacioni mbështetës vihet re se programi i studimit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm për studentët në lidhje me Kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit të cilat publikohen për të interesuarit në faqen web të UNIKO.

Kriteret dhe procedurat lidhur me transferimet, njohjen e krediteve dhe ekuivalentimin e moduleve në përputhje me Ligjin 80/2015, Kreu VII, Neni 89, janë të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të FSHNH, Kreu III, Neni 38 dhe Kreu V, Neni 70 (**Aneks II.02**) dhe në Rregulloret e programit të studimit, seksioni 15 (**Aneks II.05 MI**). Informacion rreth transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve sigurohet nga sekretaria mësimore e FSHNH dhe faqja web e UNIKO. Pranimi i studentëve në programin e studimit "Matematikë- Informatikë" bëhet mbështetur në Ligjin 80/2015, Neni 74, Pika (1) dhe (2); Statutin e UK, Kreu II, Neni 6, Pika (6) dhe Kreu VI, Neni 50 (**Aneks I.01**); Rregulloren e UK, Kreu VI, Neni 59 (**Aneks I.02**); Rregulloren e DMF, Kreu IV, Neni 31 (**Aneks II.03**) Rregulloret e programit të studimit "Matematikë-Informatikë" seksioni 7 (**Aneks II.05 MI**).

Gjatë takimit me departamentin dhe sekretarinë mësimore u vu re mungesa e studentëve të transferuar nga programe të tjera studimi dhe në këtë këndvështrim nuk ka përvoja për të vlerësuar efikasitetin e kësaj

	<p>procedure ndonëse dokumentacioni dhe organizimi nga departamenti ishte i qartë.</p> <p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës dhe bisedave me drejtuesin e departamentit dhe anëtarët e tij u vu re organizimi i qartë i këtyre komponenteve. Programi lëndor (syllabusi) hartohet për çdo lëndë/modul që përmban plani mësimor dhe pasqyron të gjithë komponentët formues, sipas formatit të VKM Nr. 41, Shtojca 2 (<b>Aneks II.03</b>). Studentëve i ofrohet në fillim të çdo viti akademik informacioni i nevojshëm mbi programin lëndor (kreditet, raportin e ngarkesës në auditor me atë jashtë auditori, frekuentimin, format e kontrollit të dijeve, vlerësimin dhe veçanërisht hapësirën që zënë ushtrimet, diskutimet në auditor, projektet apo detyrat e kursit.). Ky informacion gjendet edhe në sistemit dixhital <u>ESSE3</u>.</p> <p>Pas shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës për këtë pjesë, syllabuset për programin e studimit "Matematikë- Informatikë" të përditësuara në fillim të çdo viti akademik nuk tregojnë qartë përpjekjet e stafit kryesisht atij që mbështet ngarkesë të lëndëve aplikative me qëllim përmirësimin dhe përditësimin me referenca të viteve të fundit. (<b>Aneks I.14, Aneks II.16</b>). Kërkimi shkencor i vetë stafit, aktivitet shkencor të organizuara nga DMF dhe FSHNH (<b>Aneks III.21, Aneks III.21.1, Aneks III.21.2 dhe Aneks III.21.3</b>), nuk pasqyrojnë nxitje të përmirësimit dhe përditësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit nga stafi akademik për periudhën në shqyrtim.</p> <p>Programet lëndore sipas procedurës së ndjekur i bashkëngjiten Rregullores të programit të studimit dhe arkivohen në departament (<b>Aneks II.08 MI2018-2019, Aneks II.08 MI2019-2020, Aneks II.08 MI2020-2021</b> - Programet lëndore të programit të studimit "Matematikë-Informatikë" për tre vite; Programi lëndor hartohet nga titullari i lëndës (sipas parimeve të lirisë akademike) [<b>Aneks I.01</b> - Statuti i UK, Kreu I, Neni 3, Pika (1)] dhe konsultohet në njësinë bazë. Në përputhje me hapësirën e lëndës në planin mësimor, përcaktohet raporti i orëve në auditor me ato jashtë auditori</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

<b>Standardi II.4</b> <b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me	Referuar VKM Nr. 41 dhe Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, Kreu VII, Neni 73, Pika (1), si dhe dokumentacionit mbështetës



parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	të planeve mësimore ngarkesa e plotë e programit të studimit "Matematikë-Informatikë" është 180 kredite, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, dhe e shtrirë në 6 semestra me nga 30 kredite secili. Studentët diplomohen me provim diplome.
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim të studentëve.	Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve në programin e studimit "Matematikë-Informatikë" është i ekuilibruar ndërmjet orëve teorike dhe praktike (seminare/ushtime). Nga dokumentacioni i bashkangjitur (syllabuset/ planet mësimore) vihet re një mungesë e orëve të laboratorit qoftë në disipinat ku zhvillimi i tyre është i domosdoshëm por edhe në lëndë/ module të cilat mbështeten në shfrytëzimin e laboratoreve të informatikës/ softuerëve. Praktikrat laboratorike do mundësonin për studentët përvetësimin e dijeve me metodologji aplikative.
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.	Nga takimi me anëtarët e departamentit dhe konsultimi i dokumentacionit shoqëruar vihet re se në përgjithësi programi i studimit "Matematikë-Informatikë" ka një shpërndarje logjike të lëndëve/moduleve sipas kategorive të veprimtarive formuese. Një numër i konsiderueshëm modulesh karakterizuese dhe integruese, lidhen me veçoritë e programeve dhe japin një formim specifik të studentit. Kombinimi me orët e ushtimeve synon të nxisë tek studentët arritje të rezultateve në spektrin teorik dhe atë praktik në funksion të lehtësimin të procesit të punësimit të tyre.
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Sipas përcaktimeve nër regulloren e programeve të studimit ( <b>Aneks II.05 MI</b> seksioni 6 dhe 8), modulet janë të shpërndara në mënyrë të ekuilibruar midis veprimtarive formuese, me një raport që përputhet me atë të Shtojcës 1 të VKM Nr. 41. Referuar raportit teori-praktikë programi i studimit nga vetë orientimi në disipinat e mësuesisë është i përqëndruar në koncepte teorike dhe vihet re mungesa e lëndëve/moduleve praktike të cilat në zhvillimet më të fundit të metodologjive të mësimdhënies duhet të konsiderohen pavarësisht disiplinës së shkencave ekzakta që ka programi. Referuar emërtimeve të disa lëndëve dhe përmbajtjes së tyre tërheqim vëmëndjen në disa lëndë të disiplinave të avancuara teorike të cilat mund të zëvendësohen me koncepte të hyrjes në këto fusha studimore. (për shembull: teoria e numrave).
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektiveve formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Duke iu referuar dokumentacionit përkatës mbi planet mësimore vihet re se:
<b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.	Programi i studimit "Matematikë-Informatikë" përmban: <b>Lëndët e Formimit Bazë A</b> (zënë një peshë prej 15.6%), dhe janë të përqëndruara në njohuritë bazë të informatikës, Analiza Matematike.
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësi dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.	<b>Lëndët e Formimit Karakterizue B</b> (zënë një peshë prej 52.2%), janë të përqëndruara në njohuri të thelluara të: Analizës
<b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit	

<p>mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Matematike, Algjibrës dhe njohuritë bazë nga Gjeometria Analitike dhe Teoria e Numrave, Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimi: Programimin, Rrjetat Kompjuterike dhe Elektronikën, njohuritë bazë të fizikës.</p> <p><b>Lëndët ndërdisiplinore / integruese C</b> (zënë një peshë prej 13.9%), dhe ato me zgjedhje, të cilat synojnë aftësimin e studentëve me njohuritë bazë të Programimit JAVA, Kriptografisë, Sigurisë së Sistemeve, Gjeometrisë së Lartë, Probabilitetit dhe Statistikës.</p> <p><b>Lëndët plotësuese D</b> (zënë një peshë prej 14.4%), të cilat synojnë pajisjen e studentit me njohuritë bazë të SPSS, Matematikës së Zbatuar, Analizës Speciale, Matematikës dhe Gjeometrisë Elementare.</p> <p><b>Detyrimet përmbyllëse E</b> (me një peshë prej 3.9%), që lidhen me përgatitjen e provimit përfundimtar.</p> <p>Në këndvështrimin e profilit të mësuesisë ka disa disiplina matematikore të cilat mund të konsiderohen si lëndë të formimit karakterizues dhe disa të tjera ndërdisiplinore si përshembull: probabiliteti dhe statistika. Vëmë në dukje këtu se konceptet e probabilitetit dhe statistikës zënë një peshë të rëndësishme në kurrikulën e arsimit të ulët dhe atë parauniversitar ndaj duhet të konsiderohen të rëndësishme për profiling e një mësuesi të ardhshëm. Ndërsa: Algjebra e lartë II, Teoria e numrave janë disiplina të avancuar të cilat mund të konsiderohen për nivele më të avancuara. Të tilla organizime gjen në program në disa lëndë / module të cilat mendoj se duhen rishikuar duke i dhënë rëndësi të vecantë kurrikulave të mësuesisë dhe zhvillimeve të tyre në vite me qëllim përshtatjen e brezit të ri të mësuesve në vend.</p> <p>Në syllabusin e çdo lënde në seksionin literatura jepet referenca e plotë për çdo tekst universitar, që përdoret si literaturë bazë apo literaturë ndihmëse. Informacioni për këtë pikë gjendet në : <b><i>Aneks II.08 MI2018-2019, Aneks II.08 MI2019-2020, Aneks II.08 MI2020-2021</i></b> - Programet lëndore të programit të studimit “Matematikë-Informatikë” për tre vite;</p> <p>Referuar këtij dokumentacioni u vu re se shpesh ka lëndë ku literatura është e vjetër ndonëse ato janë lëndë të formimit bazë por edhe në situata të tjera. Stafi akademik duhet të kushtojë rëndësi plotësimin të këtyre literaturave me literatura të reja më të plota në gjuhën shqipe por edhe në pasurimin e tyre me materiale plotësuese (leksione apo shënime). Në disa raste literatura e detyruar për studentin është e mbingarkuar me mbi 5 referenca të cilat gjykojmë se e “hutojnë” studentin në përqëndrim dhe përvetësimin e koncepteve. Ndeshen gjithashtu literatura bazë të huaja dhe nuk është e qartë mënyra se si përcillen materialet në formën e leksioneve të shkruara tek studenti.</p> <p>Për disa nga literaturat e rekomanduara biblioteka dixhitale e UNIKO <u>U-LIBRARY</u> mundëson akses në EBSCO Publishing Databases, ku stafi akademik dhe studentët mund të regjistrohen,</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	

	<p>të përdorin dhe shkarkojnë revista/periodikë/libra/artikuj të dedikuar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Programet lëndore të programit të studimit Bachelor në “Matematikë-Informatikë” janë të ndërtuara në mënyrë të tillë që të mundësojnë përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. Por mendojmë se referuar komenteve më sipër ka nevojë për përmirësime /rishikime.</p> <p>Studentët mund të përshtaten në programe të ofruara nga si programi i studimit Master Profesional “Mësues në Matematikë dhe Informatikë-Fizikë”, si dhe mundësinë e ndjekjes së studimeve në Master Shkencor në çdo IAL që përkon me fushat e studimit brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Referuar dokumentacionit mbështetës (Ndërkombëtare (<b>Aneks III.21, Aneks III.21.1, Aneks III.21.2 dhe Aneks III.21.3</b>) si dhe takimeve të zhvilluara me përfaqësuesit e departamentit (drejtuesi dhe stafi akademik) vihen re përpjekje për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, të DMF duke konsultuar herë pas here me IAL të cilat ofrojnë programe të ngjashme studimi, me profesionistë të fushave përkatëse të studimit në Matematikë, Informatikë dhe Fizikë dhe me mësues me eksperience të gjatë në mësimdhënien e tyre mund të jenë më të forta. Prania e emrave të shquar të profesorëve nga IAL të ndryshme në vend (Universiteti i Tiranës) është një urë lidhëse dhe informacioni për këtë qëllim.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Referuar ( <b>Aneks IV.1, Tabelat 2</b> ) personeli akademik që mbulon lëndët e programit të studimit "Matematikë-Informatikë" përmbush kërkesat referuar Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015, Kreu VI, Neni 59, Pika 6. 95% e lëndëve të programit të studimit "Matematikë-Informatikë" mbulohe nga personeli akademik me kohë të plotë dhe 5% nga ai me kohë të pjesëshme.
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesëshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë	Personeli i programit të studimit për vitin akademik 2020-2021, përbehet nga 20 staf akademik nga ku 18 PAE ( 1 prof. Dr., 9 Dr., 8 Msc) dhe 2 PAK (Prof.As., 1 Dr.). Personeli akademik që angazhohet

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>në mësimdhënie në programin e studimit, me kohë të plotë dhe më kohë të pjesshme përmes të gjitha kërkesat ligjore në fuqi.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>Referuar CV-ve të personelit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit "Matematikë-Informatikë" vihet re se ata kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit. Personeli akademik është relativisht i ri në moshë por me përvojë mësimore dhe kërkimore të dallueshme, kjo reflektohet tek gradat dhe titujt e marrë prej tyre. Nëpërmjet procedurës së konkurimit (<b>Aneksi I.01 - Statuti i UK, Kreu V, Neni 40</b>), si personel akademik me kohë të pjesshme janë profesore të nderuar dhe me një përvojë të gjatë në fushën akademike (<b>Aneks II.09</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Kualifikimi dhe përvoja në mësimdhënie e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit "Matematikë- Informatikë" është në përputhje me lëndët që mbulon në këtë program. Anëtarët më të kualifikuar mbulojnë lëndët që kanë lidhje më të drejtpërdrejtë me specifikat e programit (<b>Aneks IV.1, Tabelat 4</b>). Personeli akademik me kohë të plotë është diplomuar dhe ka ndjekur studime të thelluara dhe kualifikime mbështetur në fushat e studimit ku mbështeten edhe programet që departamenti ofron. (matematikë-fizikë) (del në pah nga CV e stafit akademik)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në dokumentacionin dhe në takimin me anëtarët e departamentit , drejtues të fakultetit dhe universitetit (sipas axhendës që grupi i RVJ kishte) u vunë re përpjekje të DMF për të bashkëpunuar me departamentet homologe të FSHN Tiranë, duke afuar pranë tij si staf akademik me kohë të pjesshme profesorë me një përvojë të gjatë në fushën e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, kjo me qëllim për t'ju siguruar studentëve të programit të studimit "Matematikë-Informatikë" modele për nxitur tek ata dëshirën për shkencën dhe mësimdhënien në vecantni. Në funksion të këtij qëllimi DMF ka organizuar orët e hapura për studentët (<b>Aneks III.18</b>) dhe aktivitete promovuese të figurave që kanë lënë gjurmë në historinë e shkencës në Shqipëri (<b>Aneks III.22, Aneks III.22.1, Aneks III.22.2, Aneks III.22.3</b>). Ndonëse këtu vihet re mungesa e stafit akademik të brendshëm për të qënë pjesë e këtyre eventeve duke nxitur tek studentët dëshirën për studime të përqëndruara në këto disiplina.</p>
	<p>Nga vizita në laboratorët e fizikës dhe informatikës që departamenti shfrytëzon për qëllime të mësimdhënies u vu re se këto laboratore ishin efektive dhe funksionale me pajisje dhe kapacitete pritëse të mjaftueshme për numrin e studentëve dhe stafit akademik që i shfrytëzon. Në nivel Universiteti dhe Fakulteti ekzistojnë strukturat përgjegjëse për mirëmbajtjen e infrastrukturës në dispozicion të programeve të studimit dhe të laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore</p>

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1 Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	GVJ pasi morri në shqyrtim dokumentacionet e vendosura nga institucioni si, rregulloren e UK dhe rregulloren e fakultetit, rezulton se ky institucion përkrah aplikimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit. GVJ pas takimit me përgjegjësen e departamentit, dekanin dhe me Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë (KSCK), konstaton se ato zhvillojnë mekanizma monitorimi të vazhdueshme të cilësisë së mësimdhënies në të gjithë elementët e saj si leksione, seminare dhe punë laboratorike. Këto mekanizma fokusohen kryesisht në:
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimin e mësimdhënies në auditor, për personelin akademik (lektor dhe asistentë lektor) nga përgjegjësja e departamentit.</li> <li>• Vlerësimin nëpërmjet sondazhit, ku tërhiqet mendimi dhe opinion i studentëve për performancën akademike të stafit mësimdhënës.</li> <li>• Vlerësimi nga KSCK, në bazë të përgjigjeve të studentëve</li> </ul>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	Referuar RVB-së dhe nga informacioni i siguruar gjatë vizitës në institucion, rezulton se studentët para përfundimit të çdo semestri përfshihen në vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies. Përveç kontrollit periodik të realizuar nga përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me KSCK, për mënyrën e zhvillimit të leksioneve duke asistuar në leksion dhe më pas duke diskutuar konkluzionet me pedagogun dhe studentët e grupit, KSCK organizon një anketim çdo semester dhe për çdo lëndë për të vlerësuar performancën e lektorëve në mësimdhënie. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie janë Drejtoria e KSCK (nivel institucional), Njësia për
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	

*[Signature]*

**Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.

Sigurimin e Cilësisë (nivele njësie) dhe Përgjegjësi i Departamentit (njësia bazë). **(Aneksi III.13)** Rezultatet nga KSKC diskutohen në Senat dhe komentet i dërgohen Dekanit, ndërkohë që përgjegjësjë e departamentit i diskuton në mbledhjen e departamentit me stafin akademik **(Aneksi III.07.1), (Aneksi III.20), (Aneksi III.08).**

Nga takimi me përfaqësues të njësisë bazë dhe njësisë kryesore si dhe takimet me studentët u vu në dukje se: departamenti realizon periodikisht në fund të cdo semestri ose në fund të vitit akademik anketime me studentët dhe rezultatet e tyre bëhen publike pas përfundimit të procesit nga strukturat përgjegjëse. Gjatë vitit 2019-2020 u zhvilluan anektime për të monitoruar cilësinë në mësimdhënie gjatë pandemisë. Këto anketime gjatë vitit të pandemisë u realizuan online gjë që siguroi pjesëmarrjen më masive të studentëve në anketim, si dhe rriti lirinë e shprehjes së opinioneve të tyre, lidhur me problematikat që ata kanë pasur gjatë zhvillimit të mësimin online. Gjatë takimit me drejtuesin e njësisë bazë dhe drejtues të fakultetit u vu theksi dhe rëndësia që ata i kushtojnë opinioneve të studentëve, duke ndihmuar në këtë formë edhe përmirësimin e programeve të studimit.

Bazuar në dokumentacionin e ofruar nga RVB dhe takimet e anxhendës mësohet se UNIKO, FSHNH, departamenti i Matematikës dhe Fizikës në çdo vit akademik zhvillojnë analizat e punës mësimore dhe shkencore të vitit paraardhës. Analiza vjetore ofron një pasqyrë të përgjithshme të rezultateve të arritura në mësimdhënie e mësimnxënie, duke dhënë shembuj pozitivë dhe evidentuar problematika të ndryshme të konstatuara, parashikon masat për zgjidhjen e problemeve dhe përmirësimin e situatës në të ardhmen (Aneks III.08, Aneks III.08.1, Aneks III.08.2) Këto të dhëna përfshihen në raportin e analizës vjetore të UNIKO (Aneks III.09, Aneks III.09.1).

Nga diskutimet me përfaqësuesit e departamentit dhe fakultetit u vu theksi në faktin se analiza e të dhënave të pasqyruara në raportet e vlerësimit të Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NJSBC) përdoret në drejtim të rishikimit të kurrikulës, planit mësimor, programeve lëndore dhe përditësimit me njohuri bashkëkohore të dokumentacionit. Departamenti i Matematikës dhe Fizikës përfaqësohet me një anëtar tek grupi i NJSBC (Aneks III.04).

GVJ konstaton se departamenti ka një pasqyrim të dukshëm të përpjekjeve për të promovuar shembuj të praktikave të mira, nxitjes dhe inkurajimin e personelit akademik për përmirësim të mëtejshëm. Një numër i vogël i stafit akademik ka patur mundësinë të jetë pjesë e projekteve të shkëmbimit për mësimdhënie dhe trajnimeve në institucione të ngjashme brenda dhe jashtë vendit ndikuar kjo nga situata pandemike në të cilën kalon vendi.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

**Standardi III.2****Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin bashkëngjitur vihet re se: format e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programin e studimit “Matematikë-Informatikë” kryesisht leksione dhe ushtrime/seminare, me pjesë laboratorike të pakta. Detyra kursi dhe projekte janë më së shumti pjesë e lëndëve informatike dhe këtu labororet të pasqyruara në programet lëndore nuk zënë pjesë ndonëse orët e seminareve/ushtrimeve zhvillohen në laboratore.</p> <p>Personeli akademik respekton diversitetin e karaktereve dhe interesave individuale të studentëve dhe bën përpjekje që të përshtasë metodat e mësimdhënies dhe mësimnxënies me këto veçori. Raporti midis formave të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies ndryshon në varësi të natyrës së moduleve të programit. Disiplinat e informatikës ofrojnë kombinim të metodave por pjesa më e madhe e moduleve të programit të studimit Matematikë- Informatikë i përkasin fushës kryesore Matematikës, Informatikës dhe Fizikës: në një raport të përcaktuar sipas specifikave të programit të studimit përkatës. (<b>Aneks II.05 MI, seksioni 8</b>) dhe bazë të metodave mësimdhënëse dhe mësimnxënie kanë leksione/ushtrime/kolokiume/provime.</p> <p>Pjesë përbërëse të lëndëve janë seminarët, ushtrimet dhe detyrat e kursit. Format e mësimdhënies dhe numri i orëve mësimore përfshihen në syllabuset e çdo lënde e moduli. Nga vëzhgimi i ambienteve/labororeve u vu re se logjistika që ka mundësuar institucioni, kryesisht pajisja me projektorë e pjesës më të madhe të klasave, ndihmon pedagogun në përcjelljen rezultateve të dijeve tek studentët, si dhe pjesëmarrjen aktive e këtyre të fundit në mësimdhënie (<b>Aneks II.05 MI, seksionet 16</b>).</p> <p>Institucioni ka mbështetur në periudhën e pandemisë COVID-19 stafin akademik për qëllime të mësimdhënies me akses të platformave digjitale online duke mundësuar në këtë mënyrë edhe fleksibilitetin e studentit në mësimnxënie. UNIKO përmirëson dhe menaxhon infrastrukturën e mësimdhënies, nëpërmjet krijimit dhe mbështetjes teknike të aplikacioneve online të komunikimit (Moodle, Office 365 for Education), si dhe trajnimeve të personelit akademik mbi mënyrat e përdorimit të tyre.</p> <p>Në syllabuset e lëndëve vihet re se departamenti ka ndjekur politikën e ofrimit të lëndëve nga pedagogë, specifikat profesionale të së cilëve i përshtaten plotësisht karakterit të lëndës apo modulit përkatës. Gjithashtu referuar dokumentacionit bashkëngjitur (<b>Aneks III.15; Aneks III.05</b>).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al


<p>përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Gjatë vitit akademik 2020-2021, një grup pedagogësh nga departamenti i Matematikës dhe Fizikës, janë angazhuar në një sërë trajnimesh online në kuadër të projektit Tecomp me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të metodave dhe strategjive të mësimdhënies, sidomos në gjatë pandemisë. Qëllimi kryesor ka qënë përmirësimi i metodave dhe strategjive të mësimdhënies dhe përdorimin e një sërë elementësh që rrisin motivimin e studentit dhe përmirësojnë dukshëm mësimdhënien dhe mësimnxënien.</p> <p>Përfaqësuesi i njësisë kryesore, përgjegjësi i departamentit dhe stafi akademik vuri në dukje se cilësia e mësimdhënies është objekt i qëndrueshëm i analizave vjetore të mësimdhënies por edhe i vlerësimit të studentëve nëpërmjet anketimit periodik të këtyre të fundit (<b>Aneks III.13, Aneks III.13.1, Aneks III.13.2</b>).</p> <p>Rezultatet e anketimit i nënshtrohen analizës nga pedagogu, si dhe në kuadrin e departamentit, ku merren masa për të reflektuar mendimin dhe sugjerimet e studentit, me qëllim përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies (<b>Aneks III.17, Aneks III.17.1</b>).</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimimit.</p>	<p>Për periudhën në shqyrtim dhe bazuar në dokumentacionin bashkëngjitur vihet re një përpjekje e personelit akademik për të përdorur metoda interaktive dhe diskutimi gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 të cilat synojnë në rritjen e interesit të studentit gjatë orëve mësimore online. Në lëndë aplikative (informatikë/softuerike) vihet re prania e projekteve/detyrave të kursit e cila mund të vlerësohet si një përpjekje e personelit për të nxitur tek studentët dëshirën dhe motivimin për të nxënëit e këtyre disiplinave. Në këto module/lëndë puna e studentëve mbikqyret dhe mbështetet nga pedagogu/pedagogët e modulit apo lëndës përkatëse gjatë kohës së realizimit të saj, dhe si e tillë përbën një instrument të dobishëm për krijimin e marrëdhënieve ndërvepruese pedagog-student. Prezantimet individuale apo në grup janë një tjetër mënyrë për nxitjen e diskutimit midis studentëve dhe pedagogut të lëndës.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Për periudhën në shqyrtim dhe bazuar në dokumentacionin bashkëngjitur vihet re një përpjekje e personelit akademik për të përdorur metoda interaktive dhe diskutimi gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 të cilat synojnë në rritjen e interesit të studentit gjatë orëve mësimore online. Në lëndë aplikative (informatikë/softuerike) vihet re prania e projekteve/detyrave të kursit e cila mund të vlerësohet si një përpjekje e personelit për të nxitur tek studentët dëshirën dhe motivimin për të nxënëit e këtyre disiplinave. Në këto module/lëndë puna e studentëve mbikqyret dhe mbështetet nga pedagogu/pedagogët e modulit apo lëndës përkatëse gjatë kohës së realizimit të saj, dhe si e tillë përbën një instrument të dobishëm për krijimin e marrëdhënieve ndërvepruese pedagog-student. Prezantimet individuale apo në grup janë një tjetër mënyrë për nxitjen e diskutimit midis studentëve dhe pedagogut të lëndës.</p> <p>Nga takimi me personelin akademik dhe diskutimeve mbi metodat e ndryshme të mësimdhënies u vu re dëshira dhe gatishmëria e personelit akademik për të ofruar material ndihmës dhe referenca tek studentët nëpërmjet burimeve që UNIKO posedon apo edhe bibliotekës fizike në fakultet.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi III.3**

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**



<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Referuar RVB, dhe vizitës në institucion, rezulton se procesi mësimor dhe shkencor në UK realizohet në hapësira të mjaftueshme të pajisura me mjete dhe pajisje didaktike. GVJ gjatë vizitës në institucion, konstatoi se sallat e leksioneve/seminareve dhe laboratorëve, janë të mjaftueshme dhe procesi mësimor për programin, zhvillohet në godinën e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. Godinat janë të pajisura me zyra, mjedise shërbimi, mjedise për aktivitete të ndryshme, hapsira rekreative si dhe nyje hidrosanitare. Të gjitha mjediset janë të pajisura me sistem ngrohjeje.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Nga vizita në ambientet e UNIKO, dhe mjediseve që departamenti shfrytëzon rezulton se: sipërfaqja në dispozicion të zhvillimit të programit mësimor përlogaritet në 2.27 m<sup>2</sup>/student. Infrastruktura në dispozicion të mësimi është përshtatur në funksion të mësimdhënies dhe është plotësisht funksionale. Pjesa më e madhe e leksioneve realizohen në auditorë të pajisur me videoprojektorë dhe me mjetet e nevojshme për realizimin e procesit mësimor, si banka, karrike, tabela të zeza dhe tabela të bardha. Për zhvillimin e moduleve të caktuara dhe lëndëve të caktuara të Fizikës, në godinë ndodhen laboratorët e fizikës, të pajisur me të gjithë elementët e domosdoshëm për të zhvilluar si duhet procesin mësimor si dhe me hapësirën e nevojshme që studentët të mund të realizojnë punët e tyre laboratorike. Gjithashtu prania e sallave të kompjuterave në godinë, të pajisur me PC, mundëson zhvillimin e moduleve të lëndëve të informatikës. Në kuadër të projektit TECOMP, departamenti ka mundësuar pajisjen e një salle me PC cilësorë, që përdoret kryesisht nga studentët në modulet e informatikës dhe të lëndëve të tjera ku kërkohet pajisja e studentit me PC (<b>Aneks IV.07</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, takimet me grupet sipas axhendës vihet re se UNIKO ka një infrastrukturë e konsoliduar IT, në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve, e cila ofron shërbime të shumta dhe cilësore, si korrespondencë elektronike (emaili në outlook-un e Office 365), kërkim dhe shfrytëzim online të materialeve didaktike dhe shkencore, informim online të vlerësimit përfundimtar (ESSE3). Sistemi mundëson informimin e studentëve në kohë reale, lidhur me rezultatet e tyre, si dhe rrit përgjegjshmërinë e pedagogëve për vlerësimin e studentëve dhe transparencën e të gjithë procesit. Duke shqyrtuar planet mësimore, programet lëndore vihet re se për të gjithë lëndët dhe modulet e programit të studimit “Matematikë – Informatikë” ekziston literatura bazë në gjuhën shqipe, përgatitur në formën e leksioneve të shkruara (kryesisht kur literatura bazë është në gjuhë të huaj) apo teksteve mësimore. Disa prej pedagogëve kanë mundësuar botime akademike në formatet e librave mësimore dhe i shfrytëzojnë ato për qëllime të mësimdhënies dhe literaturës bazë. Në raste të tjera ofrohen literatura referencë në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj kryesisht anglisht. Vihet re se këto literatura në disa raste janë të vjetra në kohë dhe duhen përditësuar me literaturë të re (kryesisht ajo e huaj). Nga bashkëbisedimi me stafin pedagogjik u vu re</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, takimet me grupet sipas axhendës vihet re se UNIKO ka një infrastrukturë e konsoliduar IT, në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve, e cila ofron shërbime të shumta dhe cilësore, si korrespondencë elektronike (emaili në outlook-un e Office 365), kërkim dhe shfrytëzim online të materialeve didaktike dhe shkencore, informim online të vlerësimit përfundimtar (ESSE3). Sistemi mundëson informimin e studentëve në kohë reale, lidhur me rezultatet e tyre, si dhe rrit përgjegjshmërinë e pedagogëve për vlerësimin e studentëve dhe transparencën e të gjithë procesit. Duke shqyrtuar planet mësimore, programet lëndore vihet re se për të gjithë lëndët dhe modulet e programit të studimit “Matematikë – Informatikë” ekziston literatura bazë në gjuhën shqipe, përgatitur në formën e leksioneve të shkruara (kryesisht kur literatura bazë është në gjuhë të huaj) apo teksteve mësimore. Disa prej pedagogëve kanë mundësuar botime akademike në formatet e librave mësimore dhe i shfrytëzojnë ato për qëllime të mësimdhënies dhe literaturës bazë. Në raste të tjera ofrohen literatura referencë në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj kryesisht anglisht. Vihet re se këto literatura në disa raste janë të vjetra në kohë dhe duhen përditësuar me literaturë të re (kryesisht ajo e huaj). Nga bashkëbisedimi me stafin pedagogjik u vu re</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, takimet me grupet sipas axhendës vihet re se UNIKO ka një infrastrukturë e konsoliduar IT, në dispozicion të pedagogëve dhe studentëve, e cila ofron shërbime të shumta dhe cilësore, si korrespondencë elektronike (emaili në outlook-un e Office 365), kërkim dhe shfrytëzim online të materialeve didaktike dhe shkencore, informim online të vlerësimit përfundimtar (ESSE3). Sistemi mundëson informimin e studentëve në kohë reale, lidhur me rezultatet e tyre, si dhe rrit përgjegjshmërinë e pedagogëve për vlerësimin e studentëve dhe transparencën e të gjithë procesit. Duke shqyrtuar planet mësimore, programet lëndore vihet re se për të gjithë lëndët dhe modulet e programit të studimit “Matematikë – Informatikë” ekziston literatura bazë në gjuhën shqipe, përgatitur në formën e leksioneve të shkruara (kryesisht kur literatura bazë është në gjuhë të huaj) apo teksteve mësimore. Disa prej pedagogëve kanë mundësuar botime akademike në formatet e librave mësimore dhe i shfrytëzojnë ato për qëllime të mësimdhënies dhe literaturës bazë. Në raste të tjera ofrohen literatura referencë në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj kryesisht anglisht. Vihet re se këto literatura në disa raste janë të vjetra në kohë dhe duhen përditësuar me literaturë të re (kryesisht ajo e huaj). Nga bashkëbisedimi me stafin pedagogjik u vu re</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Nga bashkëbisedimi me stafin pedagogjik u vu re</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike</p>	<p>Nga bashkëbisedimi me stafin pedagogjik u vu re</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	gatishmëria e stafit për të ofruar herë pas here referenca dhe materiale ndihmëse jashtë atyre që gjenden në syllabuse me qëllim lehtësimin e mësimnxënies . (Aneks III.16).
<b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Pedagogët ofrojnë gjithashtu mundësi të shpërndarjes së informacioneve : leksionet në formatet Word dhe PowerPoint në website personal, si dhe dërgesën me email (ose duke përdorur aplikacione të tjera) studentëve përkatës. Cilësia e literaturës bazë dhe përputhshmëria e përmbajtjes së tyre me programin e studimit garantohet nëpërmjet diskutimit dhe miratimit të përmbajtjes së teksteve mësimore në departament (Aneks I.12). Tekstet mësimore depozitohen në bibliotekën e fakultetit (FSHNH) dhe tek ajo qëndrore e UNIKO-s.
<b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.	Nga vizita në ambientet e kampusit të FSHNH u prezantuar me mjediset e Bibliotekës Shkencore e Fakultetit (FSHNH) dhe gjithashtu në godinën kryesore të universitetit ku ndodhet biblioteka kryesore e universitetit. Biblioteka qëndron e hapur nga dita e hënë deri ditën e premte, në orët 08:00 - 16:00 dhe funksionon përmes kartelave të regjistrimit.
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	<p>Biblioteka e fakultetit mund të aksesohet nga pedagogë, studentë, administratë dhe punonjës të jashtëm. U vu re se burimi kryesor i informacionit janë libra, postera, harta, CD-Rom, sikundër edhe shërbim në version online. Nga informacioni që na u referua rezultoi se biblioteka e FSHNH ka një fond prej rreth 10592 libra e revista, me rreth 1031 tituj, të cilat shfrytëzohen nga studentët e pedagogët e fakultetit. Rreth 1544 libra e revista nga fondi i bibliotekës, ofrohen në gjuhë të huaj (kryesisht në anglisht, frëngjisht e italisht) dhe rreth 9048, në gjuhën shqipe. Ajo shërben njëkohësisht si sallë studimi, është e pajisur me kompjutera, paisje të tjera teknike, internet pa limit si dhe me sistem ngrohje për tju siguruar studentëve dhe pedagogëve kushte optimale (lexim, fotokopje të materialeve të bibliotekës, etj).</p> <p>Në fakultet funksionon dhe Biblioteka e Qendrës së Ekselencës me një fond të specializuar librash dhe revistash në fushën e didaktikës dhe metodologjisë së mësimdhënies në shqip e gjuhë të huaja. Biblioteka e Qendrës së Ekselencës ka një fond 190 tituj (shqip) 490 tituj (gjuhë të huaj). Salla e literaturës është e organizuar në fonde të hapura, të ndara sipas fushave të studimit. Burimi kryesor i informacionit është kryesisht bibliografik, sikurse gjendet edhe në version online.</p> <p>Biblioteka dixhitale e UNIKO (U-LIBRARY) mundëson akses në EBSCO Publishing Databases, ku stafi akademik dhe studentët mund të regjistrohen (përmes një llogarie unike dhe fjalëkalimi), të përdorin dhe shkarkojnë revista/periodikë/libra/artikuj të dedikuar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Libraria është e aksesueshme nga të gjithë studentët dhe pedagogët nëpërmjet laptopëve, tabletave dhe telefonave celularë smart.</p>

Nga takimi me studentët një pjesë e konsiderueshme e tyre pohuan se nuk e kanë aksesuar bibliotekën online dhe një arsye ishte mungesa e informacionit për ekzistencën dhe mënyrën e aksesimit të saj. Edhe stafi akademik tregoj një përpjekje të zbehur për të shfrytëzuar bibliotekën online duke e zëvendësuar atë me burime të jashtëme të aksesimit të artikujve dhe materialeve shkencore si dhe leksioneve apo materialeve ndihmëse për mësimdhënie.

Departamenti i Matematikës dhe Fizikës ka në dispozicion dy laboratorët e fizikës dhe dy laboratorët e informatikës të cilët shfrytëzohen nga studentët për qëllime të orëve laboratorike por edhe të zhvillimit të detyrave /projekteve .Gjatë vizitës sonë në ambientet e laboratoreve u vu re shfrytëzimi eficient i tyre dhe përshtypjet pozitive të studentëve.

Laboratorët e informatikës ishin të pajisur me PC me softueret e nevojshme për të kryer orët mësimore në lëndët e informatikës jo vetëm për studentët e programeve të studimit Matematikë-Informatikë, por edhe për të studentët e programeve të tjera të studimit në fakultet. Një laborator është tërësisht i rinovuar dhe me kompjutera bashkëkohorë, falë projektit ku marrin pjesë disa pedagogë të departamentit (**Aneks III.15**).

Laboratorët e fizikës kishin një infrastrukturë bashkëkohore dhe pajisje moderne që mundësojnë realizimin e programit mësimor, si dhe për të kryer punë kërkimore shkencore dhe eksperimentale të studentëve për tezat e diplomave. Këto laboratorë janë në dispozicion edhe të studentëve të programeve të tjera të studimit të cilët kanë në programin mësimor lëndë të fizikës.

Nga takimi me përfaqësues të rektoratit, fakultetit, stafin akademik dhe studentët si dhe dokumentacionit bashkangjitur rezultoi se që prej muajit Mars të vitit 2020 për shkak të pandemisë COVID-19, UNIKO ka ndërmarrë masa të menjëhershme për vazhdimin e semestrit të dytë të vitit akademik 2019-2020 si dhe vitin akademik 2020-2021 në distancë nga interneti (online) përmes platformave të ndryshme dixhitale, si Google Classroom, Google Meet, etj. kryesisht përgjatë vitit akademik 2019- 2020 dhe më tej blerja e paketës Office 365 nga UNIKO krijoi lehtësi në zhvillimin e mësimit online gjatë gjithë vitit akademik 2020-2021, duke përdorur Teams. Stafi akademik, studentët dhe stafi ndihmës akademik u trajnuan për këtë softuer.

Nga diskutimet me studentët dhe pedagogët u vu re se përvoja dhe përshtypjet e studentëve, e pedagogëve kanë nxitur përdorimin e platformave (e-learning) me qëllim përmirësimin e metodave të mësimdhënies nga distanca (online), si metoda alternative të mësimdhënies, por edhe emergjente në raste të ngjashme me atë të pandemisë. Studentët dhe pedagogët shfrytëzojnë komunikimet nëpërmjet postës elektronike për shkëmbim informacioni dhe material

	<p>didaktike. Faqja personale e pedagogut është gjithashtu një mënyrë e shpërndarjes së informacionit tek studentët dhe kolegët.</p> <p>Studentët në programin te studimit “Bachelor” në “Matematikë-Informatikë” gjatë viteve akademike 2019- 2020, 2020-2021 dhe 2021-2022 kryejnë provim formimi. Kjo është vendosur me vendim departamenti gjatë viteve të fundit, duke marrë në konsideratë natyrën teorike të lëndëve dhe moduleve në këto programe studimi. Fondi i pyetjeve është i organizuar në mënyrë të tillë që lëndët e analizës matematike, algjibrës, gjeometrisë dhe probabilitetit përbëjnë shtyllat kryesore të matematikës ku duhet të orientohen studentët për të dyja programet e studimit. Ndërsa lëndët e informatikës dhe fizikës ndryshojnë zënë një përqindje më të ulët sipas planit mësimor të miratuar.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nIVel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nIVel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktiVitetet në kuadër të përmirësimin të cilësisë së mësimdhënies.	<p>Bazuar në dokumentacionin bashkëngjitur dhe takimeve sipas axhendës rezultoi se: në UNIKO ekzistojnë struktura të posaçme në funksion të lehtësimin dhe monitorimit të procesit mësimor, në përputhje me Udhëzimin nr. 27, dt. 29.12.2017 të MASR "Për strukturat e brendëshme akademike dhe administrative në institucionet publike të Arsimit të Lartë" (<b>Aneks III.26</b>).</p> <p>Në nivel institucional, funksionojnë Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimin Institucional, në varësi të së cilës gjendet: Sektori i Kurrikulës, Vlerësimin Institucional dhe Alumni; Drejtoria e Projekteve dhe Kërkimit Shkencor, në varësi të së cilës gjendet: Sektori i Projekteve dhe Kërkimit. Të gjitha këto struktura mbikqyrin dhe implementojnë rregulloret, programet e studimit, proceset akademike dhe jo akademike, dhe sigurojnë përputhjen e tyre me kuadrin ligjor, në bashkëpunim dhe me aktorët shoqërorë. Gjithashtu, sipas parashikimeve statutove zëvendësdekanët në FSHNH është përgjegjës për ecurinë e procesit mësimor dhe garantimin e cilësisë së tij.</p> <p>Mbështetur në dokumentacionin e ofruar Departamenti i Matematikës dhe Fizikës është përgjegjës kryesor për cilësinë e mësimdhënies në programin e studimit “Matematikë- Informatikë”. Departamenti monitoron procesin e mësimdhënies / mësimnxënies dhe atë të vlerësimin të studentëve, si dhe kryen analiza periodike në lidhje me mësimin dhe kërkimin shkencor (<b>Aneks III.08</b>).</p>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	
<b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovatiVe të mësimdhënies.	
<b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës	

<p>kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Departamenti i Matematikës dhe Fizikës inkurajon aktivitetin shkencor të stafit akademik dhe përfshirjen e studentëve në projekte dhe veprimtari të ndryshme (<b>Aneks III.23, Laboratori i Dijes</b>). Ky aktivitet analizohet periodikisht gjatë analizave vjetore të DMF (<b>Aneks III.08</b>). Performanca vjetore e stafit akademik dhe nxitja e tyre monitorohet e vlerësohet rregullisht nëpërmjet plotësimit të formularëve të hartuara për këtë qëllim, të kërkuara nga Departamenti i Matematikës dhe Fizikës dhe nga rektorati i UNIKO-s (<b>Aneks III.27</b>). Platformat dixhitale dhe përdorimin eficient të tyre tregohet nga takimet me stafin dhe përfaqësues të fakultetit, universitetit se kontribuan në realizimin me sukses të mësimdhënies gjatë kësaj periudhe (<b>Aneks II.18.1</b>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Në nivel institucional, cilësia e mësimdhënies promovohet dhe monitorohet nga Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (<b>Aneks I.16</b>), e cila ka si qëllim kryesor të monitorojë veprimtarinë e sigurimit të cilësisë në Universitet dhe të bashkërendojë komunikimin mes tij dhe institucioneve të vlerësimit të jashtëm që përcaktojnë kriteret e cilësisë në arsimin e lartë shqiptar. Gjithashtu të evidentojnë problematikat në lidhje me mësimin dhe të nxënit, cilësinë e mësimdhënies; sigurimin e bazës së të dhënave për cilësinë e mësimdhënies dhe nxitjen e kompetencave të të nxënit, etj.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.</p>	<p>Gjatë vitit akademik 2019-2020 UNIKO i ka kushtuar një rëndësi të veçantë dixhitalizimit të procesit të mësimdhënies, si pasojë e situatës së pandemisë së COVID-19. Kjo u arrit duke prezantuar dhe shfrytëzuar platforma dixhitale të cilat kontribuan në realizimin me sukses të mësimdhënies gjatë kësaj periudhe përmirësimin sasior dhe cilësor të metodave të mësimdhënies / mësimnxënies në të ardhmen. (<b>Aneks II.18.1</b>).</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Përsa i përket trajnimit të stafit akademik në kurset afatshkurtra dhe mobiliteti, si dhe format inovative të trajnimit profesional janë të vakëta. Gjatë takimit me stafin akademik u vu re dëshira e tyre për të përmirësuar programet e studimit dhe implementimin e metodave të reja ndonëse pjesmarrja në evente dhe trajnime me fokus kryesor metodologjitë inovative në mësimdhënie është e vakët. UNIKO ka ofruar gjatë periudhës në shqyrtim trajnime të stafit kryesisht për platforma digjitale:</p> <p>Trajnimi mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• përdorimin e sistemit të integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve në UNIKO, ESSE3.</li> <li>• platformat e integruara të mësimin për studentët dhe pedagogët [Moodle, eduMEET].</li> <li>• EBSKO në përdorimin e U-LIBRARY</li> <li>• përdorimin e aplikacioneve të paketës Office 365 for Education për mësimdhënien dhe komunikimin online (<b>Aneks II.18 dhe Aneks II.18.1</b>).</li> <li>• orët e hapura të mësimin si mjet për shkëmbimin e</li> </ul>

	<p>përvojave midis stafit akademik me përvojë dhe stafit të ri akademik kjo tregohet në (<b>Aneks III.18, Aneks III.18.1</b>).</p> <p><i>Përsa i përket trajnimit të stafit akademik në kurset afatshkurtra dhe mobiliteti, si dhe format inovative të trajnimit profesional janë të vakëta. Edhe në ato raste kur stafi ka qënë pjesë e këtyre trajnimeve nuk duket qartë benefiti për departamentin, stafin dhe studentët.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			<b>X</b>	

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Sipas dokumentacionit bashkëngjitur rezulton se kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale, të studentëve në programet e studimit “Matematikë- Informatikë” dhe “Matematikë-Fizikë”, janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar në Rregulloren e UNIKO Kreu VI, Neni 82 dhe 83 ( <b>Aneks I.02</b> ) dhe gjithashtu edhe në Rregulloret e Programit të Studimit të ciklit të parë “Matematikë-Informatikë” ( <b>Aneks II.05 MI</b> seksioni 14).
<b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Çdo student në fillim të vitit akademik/ciklit tre vjeçar të studimeve prezantohet nga ana e personelit akademik me metodologjinë edhe sistemi i vlerësimit të njohurive. Ky proces zhvillohet përgjatë semestrit dhe finalizohet me zhvillimin e provimit në fund të semestrit dhe shpalljen e përfundimeve. Veçoritë specifike të testimit të njohurive dhe aftësive profesionale të cilat përfshijnë mënyrat e vlerësimit dinamik, periudhat e kontrollit, rezultatet si dhe ankimimet janë të specifikuar në Rregulloren e UNIKO.
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Sistemi i vlerësimit të dijës dhe ndarjes së pikëve midis elementëve të vlerësimit, përcaktohen në mënyrë të detajuar nga çdo titullar lënde në programin lëndor dhe iu bëhen të njohura studentëve, në fillim të procesit mësimor nga pedagogu i lëndës, si edhe nëpërmjet sistemit ESSE3. Informimi i studentëve lidhur me vlerësimin e dijeve bëhet nëpërmjet sistemit ESSE3.  Në fillim të semestrit studentët njihen me nga cdo anëtar i stafit akademik që zhvillon lëndën i cili i njih me përmbajtjen e syllabusit dhe informacionin e nevojshëm që përmban ai. Emërtimi, kreditet e lëndës, pedagogët e zhvillimit të lëndës, viti, semestri kur zhvillohet lënda, vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit, ngarkesa në orë në auditor si orë mësimore dhe jashtë tij. Ai njihet me detyrimet e tij, format e vlerësimit, literaturën e detyruar dhe atë të rekomanduar.  Referuar Rregulloreve të programit të studimit “Matematikë-Informatikë” dhe programeve lëndore ( <b>Aneks II.08 MI2018-2019, Aneks II.08 MI2019-2020, Aneks II.08 MI2020-;</b> ) testimi dhe

	<p>vlërësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive realizohet: në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë zhvillimit të lëndës/modulit.</p> <p>Sipas organizimit vihet re se testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të studentëve ndahet në vlerësimin e vazhduar (deri në 30%) të totalit të pikëve dhe realizohet disa forma vlerësimi., përfshirë organizimin e seminareve, detyrave të ndërmjetme, ushtrimeve dhe punëve laboratorike, mbrojtjen e detyrave dhe projekteve të kursit, etj. Provimi përfundimtar zë deri në 70% të totalit të pikëve dhe realizohet me shkrim, me gojë, ose i kombinuar me shkrim dhe gojë cilësuar në çdo syllabus moduli. Kjo mënyrë kontrolli dhe testimi i jep studentëve mundësinë të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara gjatë semestrit apo vitit akademik.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.6</b>	
<b>Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.	Referuar dokumentacionit të paraqitur nga RVB si dhe takimeve të zhvilluara sipas axhendvs, RVJ konstatoi se: testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe mbyllet me vlerësimin/notën përfundimtare. Mënyra e vlerësimit është e përcaktuar qartë për cdo lëndë/modul. Lëndët janë të organizuara në dy pjesë: vlerësimi i vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit (30%), si dhe vlerësimi përfundimtar (70%). Përcaktimi i raporteve mes vlerësimit të vazhduar gjatë vitit dhe vlerësimit përfundimtar bëhet nga pedagogu/ët në programin e modulit dhe iu bëhet e ditur studentëve me fillimin e modulit mësimor ( <b>Aneks II.05 MI</b> , seksioni 14').
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Sistemet elektronike të vlerësimit janë përdorur gjerësisht nga stafi akademik i UNIKO dhe departamenti gjatë periudhës së pandemisë në vitin akademik 2020-2021. Testimi e vlerësimi elektronik është aplikuar në module të ndryshme të programit të studimit nëpërmjet platformave online që ofron universiteti si: <i>Moodle, Google Classroom, Office 365 for Education, etj.</i>
<b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.	Referuar dokumentacionit të gjendur në ( <b>Aneks II.02</b> – Kreu IV, Neni 61), si dhe takimit me stafin akademik dhe sekretarinë mësimore: testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve, të përcaktuara nga përgjegjësi i departamentit me jo pak se 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit ( <b>Aneks I.02</b> - Rregullorja e UNIKO, Kreu VII, Neni 100). Pikët e vlerësimit të vazhduar hidhen në sistemin ESSE3 dhe ruhen nga sistemi dhe në sezonet e tjera të provimeve nëse studentët nuk marrin notë kaluese gjatë sezonit të rregullt. Kopjet e çfarëdo
<b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.	
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>forme janë të ndaluara gjatë provimeve, dhe në rast kopjimi studenti përjashtohet nga provimi dhe merr notë negative në provimin përkatës. Mbështetur në rregulloren e UNIKO, rezultatet e provimit hidhen në sistem nga komisioni i provimit brenda dy ditëve kur provimi është me gojë dhe brenda 6 ditëve kalendarike nga data e kryerjes së provimit kur provimi është me shkrim ose me shkrim dhe gojë.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>Ka një komunikim me synim këshillues për studentin për ta ndihmuar atë të orientohet për të përmirësuar arritjet dhe përvetësimin e koncepteve të marra gjatë periudhës së mvsimit. Kjo del në pah edhe nga takimi me studentët. Procedura që ndiqet është e qartë: pasi studenti njihet me rezultatet e provimit, ai ka të drejtë të paraqitet para komisionit të provimit për t'u sqaruar apo diskutuar lidhur me rezultatet e tij në provim. Gjatë kësaj procedure studentit i paraqitet teza e provimit e zgjidhur, në rastet kur përgjigjia e dhënë prej tij nuk është e saktë, në mënyrë që të informohet për përgjigjen korrekte. <b>(Aneks I.02; Aneks II.02 – Kreu IV, Neni 61).</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Gjatë zhvillimit të provimit komisioni monitoron studentët për të shmangur kopjimet apo mashtrimet me mjete jo të lejueshme (Studenti që në provim përdor forma e mjete të palejueshme ose pengon zhvillimin e rregullt të tij përjashtohet nga provimi). Nga takimi me stafin akademik si dhe sekretarinë mësimore u mësua se: Studentët informohen brenda afateve të përcaktuara mbi rezultatet e provimit në librezën e tyre elektronike, por nëse nuk e kanë marrë këtë informacion për arsye të ndryshme, mund të informohen pranë sekretarisë së departamentit. Këto rregulla ndiqen në përputhje me Rregulloren e UNIKO.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Referuar <b>(Aneks II.02– Kreu IV, Neni 67)</b> si dhe takimeve të zhvilluara me përfaqësues të departamentit, sekretarinë mësimore si dhe grupit të studentëve: studenti ka të drejtë të ankohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa bëhet me shkrim brenda ditës së zhvillimit të provimit me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë për provimet me shkrim, nga data e dhënies së tij dhe i drejtohet Dekanit të Fakultetit. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës brenda dy ditëve. Ky vendim është i formës së prerë. Ankesa e paraqitur shqyrtohet nga Dekani, i cili duhet të komunikojë për sqarime përgjegjës të departamentit përkatës, komisionin e provimit, si dhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë apo jo dhe merr vendimin përkatës. Ky vendim është i formës së prerë. Kur ankesa është e drejtë, Dekani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit për të cilin studenti është ankuar dhe vendos në bashkëpunim me përgjegjës të departamentit, që studenti të rijapë provimin, me një komision me anëtarë të tjerë, në një datë tjetër brenda sezonit ose jashtë tij, por jo më vonë se 5 ditë nga përfundimi i sezonit përkatës të provimeve. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë mbahet në Dekanat <b>(Aneks II.02– Kreu IV, Neni 67).</b></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	



Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7 Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësiVe krijuese e zbatuese të studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohuriVe, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Referuar dokumentacionit të paraqitur nga RVB programi i studimit “Matematikë-Informatikë” ka një qëllim kryesor në drejtimin mësimdhënës dhe shkencor të programit të studimit Bachelor. Ky program është hartuar mbi tre drejtime kryesore: <ul style="list-style-type: none"> <li>Mbi njohuritë bazë dhe të thelluara të matematikës.</li> <li>Mbi njohuritë bazë dhe të thelluara të informatikës</li> <li>Mbi njohuritë bazë të fizikës.</li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Referuar dokumentacionit mbështetës kurrikula e programit të studimit “Matematikë-Informatikë” mundëson zhvillimin e aftësive të vecanta të studentëve në fusha të ndryshme. (Aneks II.07.2 MI2018-2019, Aneks II.07.2 MI2019-2020, Aneks II.07.2 MI2020-2021) dhe programet lëndore (Aneks II.08 MI2018-2019, Aneks II.08 MI2019-2020, Aneks II.08 MI2020). Studentët e programit të studimit “Matematikë-Informatikë” marrin njohuri të thelluara edhe në fushën e teknologjisë së informacionit. Bazuar në planet mësimore dhe programet lëndore në vitin e parë dhe të dytë të studimit, kurrikulat e programit të studimit “Matematikë-Informatikë” nëpërmjet moduleve specifike, si Anglishte e përgjithshme, Anglishte profesionale, Logjikë formale, Filozofi, i ndihmojnë studentët në zhvillimin e aftësive në shkencat humane sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit.
<b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	
<b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.	
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	Mbështetur në dokumentacionin e ofruar dhe diskutimet në takimet sipas axhendës janë të qarta kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti të cilat analizohen në përfundim të çdo lënde/moduli si rezultante e kombinuar e vlerësimit të vazhduar gjatë vitit për elementët e përcaktuar në programin e modulit (Aneks II.08 MI2018-2019, Aneks II.08 MI2019- 2020, Aneks II.08 MI2020;), me vlerësimin në provim. Elementët e vlerësimit të vazhduar përfshijnë testime të ndërmjetme, me shkrim e me gojë, detyra/projekte kursi, etj Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, mangësitë e vërejtjet, analizohen e
<b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

99/14

<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>shqyrtohen në përfundim të modulit/lëndës edhe nëpërmjet anketimit (<b>Aneks III.17, Aneks III.17.1</b>).</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>Nga takimi i zhvilluar me stafin akademik dhe drejtuesin e njësisë bazë si dhe grupit përfaqësues të studentëve u konfirmua se: në përfundim të modulit/lëndës, personeli akademik e orienton studentin lidhur me përgatitjen për provimin përfundimtar duke u vënë në dispozicion fondin e pyetjeve, mënyrën e organizimit dhe informacione të tjera që studenti ka nevojë për testimin final. Gjithashtu, me kërkesë të studentëve pedagogu i lëndës/modulit zhvillon seanca konsultimesh përpara zhvillimit të provimit duke i orientuar ata në përvetësim të njohurive.</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>Si pjesë e veprimtarisë ekstrakurrikulare janë edhe orët/leksionet e hapura me lektorë të ftuar. Referuar dokumentacionit mbështetës vihet re se FSHNH dhe në veçanti departamenti i Matematikës dhe Fizikës në bashkëpunim me departamente të tjera organizojnë leksione të hapura mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë, jashtë strukturës së programit të studimit kryesisht dhe me punimet shkencore të personelit akademik të departamentit dhe të ftuar nga Universitete të tjera (<b>Aneks III.18, Aneks III.18.1</b>). Ndonëse ka një tentativë për të zhvilluar këtë pjesë ende është i vakët aktivizimi i stafit të brendshëm për organizimin e orëve të hapura dhe seminareve jashtë strukturës së programit të studimit.</p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Mësimdhënia në programin e studimit Bachelor në “Matematike-Informatike” kombinon formimin teorik dhe përvojën praktike e cila realizohet nëpërmjet detyrave të kursit dhe seancave laboratorike ndonëse këto të fundit janë të pakëta në syllabuse vendin e tyre e zënë projekte dhe detyrat e kursit.</p> <p>Nga takimi me stafin akademik dhe drejtuesin e departamentit ku programi i studimit “Matematikë- Informatikë” zhvillohet vihet re dëshira dhe gadishmëria e tyre për të mbështetur dinamikën e punës në grup. Pedagogët që kanë të mundur organizimin e lëndëve në detyra/projekte i nxisin studentët të kombinohen në grupe pune për realizimin e detyrave/projekteve të kursit, analizës së rasteve të studimit apo punimit të diplomës, duke synuar që të pasurojnë diskutimet dhe këndvështrimet në ekip dhe mundësojnë zgjidhjen e problematikave në mënyrë inovatore dhe të integruar.</p> <p>Personeli akademik i brendshëm dhe i ftuar krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve. Në dispozicion të studentëve është sidomos infrastruktura</p>

laboratorike, në mënyrë që ata të mund të realizojnë një punë kërkimore si dhe të kryejnë eksperimente apo të zhvillojnë idetë e tyre duke pasur edhe asistencën e personelit akademik si dhe të atij ndihmës akademik në çdo iniciativë të tyre. Gjithashtu studentët e programeve të studimit “Matematikë- Informatikë”, kanë në dispozicion përveç infrastrukturës laboratorike edhe bibliotekën e fakultetit, bibliotekën e qendrës së ekselencës dhe libraritë online me qëllim kërkimin bibliografik në studimet e tyre.

Nga takimi me stafin akademik, studentët dhe drejtuesit e njësisë kryesore vihet re dëshira e FSHNH për të nxitur dhe mbështetur përfshirjen e studentëve, kryesisht studentët e nivelit master për zhvillimin e ideve inovative dhe studimeve të avancuara kërkimore e shkencore, duke mos limituar edhe përfshirjen e studentëve të programeve të studimit Bachelor.

Pavarësisht dëshirës për të nxitur dhe mbështetur studentët e programit të studimit “Matematikë-Informatikë” në aktivitete të ndryshme shkencore të organizuara në fakultet si dhe në aktivitete të organizuara nga vetë studentët mungojnë këto aktivitete të organizuara nga vetë studentët e këtij programi studimi. Disa aktivitete të ngjashme por nga studentë të programeve të tjera të studimit është: “Shija e pse-ve” (**Aneks III.28**). FSHNH vuri në dispozicion mjediset e fakultetit dhe asistencën e nevojshme të stafit për të zhvilluar me sukses këtë aktivitet përkatës.

UNIKO ka bërë përpjekje të vazhdueshme për të rritur bashkëpunimin me institucione të tjera në arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit. Ai ka qenë dhe është pjesë e disa projekteve bashkëpunimi me qëllim nxitjen e mobiliteteve (Erasmus +).

*Duhet të nxitet më shumë nga departamenti dhe stafi akademik gjithashtu mobiliteti i studentëve në institucione të tjera jashtë vendit.*

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

### Standardi III.8

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e

Bazuar në Rregulloren e brendëshme të FSHNH (**Aneks II.02**), në Rregulloren e njësisë bazë (**Aneks II.03**) dhe në Rregulloren përkatëse

<p>diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>të programit të studimit (<b>Aneks II.05 MI</b>) diplomimi për programin e studimit “Matematikë-Informatikë” realizohet nëpërmjet shlyerjes së provimit të formimit. Provimi i Formimit Përfundimtar përbëhet në masën 55% me kontroll njohurish nga disiplinat e matematikës dhe 45% me kontroll njohurish nga disiplinat e informatikës. Pyetjet e Provimit të Formimit Përfundimtar nga disiplina e matematikës dhe informatikës, zgjidhen në mënyrë të rastësishme nga një manual i përcaktuar më parë. Manuali i pyetjeve (<b>Aneks II.15 MI</b>), ushtrimeve dhe problemeve mundësohet për studentët pranë sekretarisë së Departamentit që mbulon Programin e Studimit, brenda muajit dhjetor të semestrit të parë të vitit të tretë të Programit të Studimit. Gjithashtu, studenti do të njihet më parë me mënyrën e hartimit të tezës dhe me skemën e zhvillimit të Provimit të Formimit Përfundimtar.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Nga takimi me drejtuesin e departamentit, stafin akademik, sekretari amësimorë dhe studentët si dhe dokumentacionit bashkangjitur u mësua se: studentëve i ofrohet mbështetje për informimin, sqarimin dhe saktësimin në detaje për dhënien e provimit të formimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Në mbështetje të studentit në këtë proces janë gjithashtu:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Drejtuesi i njësisë bazë, i cili monitoron dhe informon në vijimësi;</li> <li>• Sekretaritë e programeve përkatëse, të cilat vënë në dispozicion të studentëve manualin e pyetjeve, ushtrimeve dhe problemeve.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Studentët testohen me provimin e formimit përpara komisionit të përbërë nga 3 anëtarë, pedagogë në fushat kryesore të studimit. Ky komision përcaktohet nga përgjegjësi i departamentit dhe miratohet nga dekani i Fakultetit para fillimit të provimit të formimit (<b>Aneks III.25</b>).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Stafi akademik u ofron studentëve mbështetje për informimin për provimin e formimit. Departamenti harton plane për kryerjen e konsultimeve me studentët, si dhe i ve në dispozicion studentëve materiale shtesë që ti ndihmojnë në përvetësimin e koncepteve.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e UNIKO skema e vlerësimit të studentëve është me notë dhe bëhet bazuar në nenin 104 të Rregullores së UNIKO (<b>Aneks I.02</b>) dhe përfshihet tek seksioni 14 i Rregulloreve të programeve të studimit (<b>Aneks II.05 MI, Aneks II.05 MF</b>), ajo vlen edhe për provimin e formimit. Në vlerësimin përfundimtar mblidhen pikët e grumbulluara nga studenti në disiplinat e matematikës me pikët e grumbulluara nga disiplinat e fizikës dhe informatikës përkatësisht sipas programeve të studimit. Në përfundim të procesit të provimit, komisioni shpall rezultatet. Rezultatet hidhen në sistem dhe procesverbali firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit të diplomimit, si dhe nga personat e tjerë përgjegjës.</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga</p>	

ministra përgjegjëse për arsimin.	Duke konsultuar dokumentacionin si dhe pas takimeve me përgjegjesin e departamentit dhe përfaqësues të fakultetit, universitetit konfirmohet se: në përfundim të studimeve në programin Bachelor “Matematikë-Informatikë”, pasi ka përmbyllur të gjitha detyrimet përkatëse, studenti pajiset me diplomë Bachelor.			
<b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Kjo diplomë shoqërohet me suplementin/shtojcën e diplomës, sipas modelit të miratuar nga Ministria e Arsimit ( <b>Aneks II.06 MI</b> ). Dorëzimi i diplomës bëhet në ceremoninë e diplomimit <u>Dita Akademike</u> të organizuar nga UNIKO. Të dhënat mbi diplomimin regjistrohen në Regjistrin e Lëshimit të Diplomave dhe Certifikatave, si dhe në Regjistrin Bazë.			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	FSHNH i ruan të dhënat e mësipërme edhe në formë elektronike në sistemin ESSE3. Sekretaria mësimore e FSHNH dokumenton tërheqjen e diplomës dhe suplementit të diplomës prej secilit student, që ka përfunduar me sukses detyrimet akademike.  Mbështetur në dokumentacionin shoqërues dhe takimeve me përfaqësues të departamentit dhe sekretarisë mësimore ( <b>Aneks II.06 MI</b> ) në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomën e cila paraqet kopjen e zyrtarizuar të programit të studimit përkatës, “Matematikë-Informatikë”. Elementët përbërës, forma e diplomës dhe procedurat për regjistrimin janë përcaktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Përpara lëshimit diploma regjistrohet në regjistrin shtetëror të diplomave. Diploma shoqërohet me suplementin e diplomës, e shkruar në gjuhën angleze dhe gjuhën shqipe.  Sipas ( <b>Aneks I.09</b> ) dhe vizitës në sekretarinë mësimore sipas axhendës së vizitës rezulton se dokumentacioni i regjistrimit të studentit ruhet në sekretarinë mësimore të fakultetit edhe pas diplomimit të tij. Të dhënat e tjera, si arritjet akademike, të dhënat e diplomimit, numri i diplomës, data e diplomimit dhe nota e diplomës, ruhen dhe vihen në dispozicion të studentit me kërkesën e tij. Bashkë me diplomën dhe aneksin e saj, studentëve iu vihet në dispozicion një kopje e plotë zyrtare e programit të studimit, “Matematikë-Informatikë”. Gjithashtu, çdo institucioni tjetër që në formë ligjore drejton kërkesë pranë UNIKO, i vihen në dispozicion të dhënat e mësipërme, gjithmonë në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardevë të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësuesit e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit të UNIKO si dhe dokumentacionit mbështetës u vërejt se mbështetur në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimin e Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore, Neni 4, Pika (c) dhe Neni 5, Pika (3) (<b>Aneks I.04</b>) mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat mbi personelin akademik, ndihmës mësitor, shkencor dhe administrativ. Kjo bazë të dhënash përfshin kontratat e punës konform legjislacionit dhe akteve të tjera të brendshme, CV akademike, organizimin e kohës vjetore të punës, planin e ngarkesës mësimore, dosjet e pedagogëve, etj.</p> <p>Planet mësimore të programit të studimit “Matematikë-Informatikë” (<b>Aneks II.07 MI</b>), jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programet e studimit (<b>Aneks II.09</b>), formati i dosjes personale mësimore të stafit (<b>Aneks II.16</b>). Mbulimi i programit të studimit “Matematikë-Informatikë” dhe “Matematikë- Fizikë” mundësohet nga pedagogë efektivë me kohë të plotë dhe pedagogë me kohë të pjesshme. Në <b>Aneksin IV.01</b> paraqiten tabelat përmbledhëse të realizimit të ngarkesës mësimore vjetore [sipas përcaktimeve në Rregulloren e UNIKO, Kreu V, Neni 36 (<b>Aneks I.02</b>)], të stafit akademik të programit të studimit “Matematikë-Informatikë” për tre vitet e fundit. Në <b>Aneksin IV.02</b> paraqiten tabelat përmbledhëse të realizimit të ngarkesës mësimore vjetore të stafit akademik të Departamentit të Matematikë-Fizikës për tre vitet e fundit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësuesit e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit të UNIKO si dhe dokumentacionit mbështetës u vërejt se veprimtaria rekrutuese e UNIKO karakterizohet nga transparenca ndaj publikut, paanshmëria, shanse të barabarta të konkurimit dhe zbatim rigoroz i kriterëve ligjore të parashikuara në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Neni 64, Pika (1) dhe Kodit të Punës. Në zbatim të këtij ligji, në Rregulloren e UNIKO, Kreu V, Neni 32 (<b>Aneks I.02</b>), parashikohen kriteret e përgjithshme. Kriteret specifike përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, dhe miratohen nga rektori [Statuti i UK, Kreu V, Neni 40 (<b>Aneks I.01</b>)]. UNIKO ka një rregullore të posaçme rekrutimi (<b>Aneks I.13</b>).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Nga takimi me përfaqësuesit e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Komunikimit dhe Promocionit të UNIKO si dhe dokumentacionit mbështetës u vërejt se veprimtaria rekrutuese e UNIKO karakterizohet nga transparenca ndaj publikut, paanshmëria, shanse të barabarta të konkurimit dhe zbatim rigoroz i kriterëve ligjore të parashikuara në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Neni 64, Pika (1) dhe Kodit të Punës. Në zbatim të këtij ligji, në Rregulloren e UNIKO, Kreu V, Neni 32 (<b>Aneks I.02</b>), parashikohen kriteret e përgjithshme. Kriteret specifike përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit, dhe miratohen nga rektori [Statuti i UK, Kreu V, Neni 40 (<b>Aneks I.01</b>)]. UNIKO ka një rregullore të posaçme rekrutimi (<b>Aneks I.13</b>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Procedura për rekrutimin e personelit pranë UNIKO administrohet nga Drejtoria Juridike dhe të Burimeve Njerëzore (<b>Aneks I.04</b>). Pas publikimit të shpalljes së vendit vakant në Buletinin e Njoftimeve</p>

	<p>Publike dhe në <u>faqen web</u> të UNIKO, kandidatëve potenciale ju jepet mundësia të depozitojnë dokumentacionin përkatës brenda afatit të përcaktuar në njoftim (<b>Aneks IV.03</b>). Kriteret e punësimit sanksionojnë zhvillimin e një konkursi publik, të hapur dhe të paanshëm. Në Statutin e UNIKO, Kreu V, Neni 40 (<b>Aneks I.01</b>), përcaktohet procedura e rekrutimit, e zhvillimit të konkursit, si dhe e ngritjes së Komisionit Ad Hoc (Aneks IV.04). Kompetenca themelore e këtij komisioni të posaçëm është shqyrtimi i pajtueshmërisë së dokumentacionit të depozituar nga ana e kandidatëve, me kriteret e përgjithshme të përcaktuara në ligj dhe rregullore, dhe kriteret specifike të përcaktuara nga njësi bazë.</p> <p>Mbështetur në dokumentacion dhe takimit me drejtorinë Juridike të Burimeve Njerëzore rezultojnë se mënyra e vlerësimit të kandidatëve, që punësohen si personel akademik, realizohet sipas Udhëzimit të Rektorit të UNIKO, Nr. 594, dt. 08.10.2018 "Për vlerësimin e kandidatëve që punësohen si personel akademik" (<b>Aneks I.13</b>). Për të diferencuar cilësinë e personelit, epërsi i jepet kriterit të specialitetit të diplomës universitare dhe notës mesatare, i cili është edhe kriter skualifikues. Në Pikën (5) të këtij Udhëzimi, parashikohet se në rast se, në fund të procesit të vlerësimit do të rezultojnë kandidatë me pikë të barabarta, atëherë përparësi do t'i jepet kandidatit që zotëron diploma të fituara në universitete të njohura të vendeve të OECD.</p> <p>Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, nënshkruhet Kontrata individuale e punës ndërmjet fituesit dhe Rektorit si autoriteti përfaqësues i UNIKO (<b>Aneks IV.05</b>). Pas nxjerrjes së urdhërit të emërimit (Aneks IV.06) prej Rektorit, kandidati fitues ushtron kompetencat e marra përsipër në kontratën individuale të punës.</p> <p>Përsa i përket rekrutimit të pedagogëve me kohë të pjeshme, procedura paraprihet nga një mbledhje e zhvilluar në nivel departamenti. Departamenti diskuton shpërndarjen e ngarkesës mësimore dhe propozon kriteret specifike që kanë në bazë specialitetin, disiplinën dhe kualifikimin.</p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="534 1422 742 1489">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="742 1422 933 1489">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="933 1422 1125 1489">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1125 1422 1327 1489">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="534 1489 742 1547"></td> <td data-bbox="742 1489 933 1547"></td> <td data-bbox="933 1489 1125 1547"></td> <td data-bbox="1125 1489 1327 1547" style="text-align: center;"><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e	Nga takimi me drejtuesit e fakultetit dhe departamentit si dhe stafin akademik të departamentit vihet në dukje angazhimi i FSHNH në krijimin e një mjedisi mbështetës që promovon rritjen dhe zhvillimin profesional me mundësi të barabartë për personelin. Personelit i janë

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

detyrave të personelit në mënyrë profesionale.	krijuar mundësi të barabarta për kualifikim shkencor dhe përfshirje në aktivitetet kërkimore- shkencore. Mjediset e punës, laboratorët, sallat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, janë lirisht të aksesueshme nga personeli për kryerjen me profesionalizëm të detyrave të tyre.			
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.	Nga takimi me Drejtorinë e Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor dhe Koordinatorin e projekteve Erasmus + u mësua se UNIKO është angazhuar në politikat integruese të personelit të vet, duke i dhënë mundësi për trajnime dhe kualifikime të ndryshme në përputhje me fushat e studimit. Gjithashtu UNIKO ka ndjekur politikat për të integruar personelin duke e përfshirë atë nëpër projekte dhe veprimtari të ndryshme shkencore. Personeli akademik nxitet vazhdimisht për të realizuar kualifikime apo specializime, si pjesë e përparimit akademik ose në funksion të mësimdhënies.			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.	UNIKO inkurajon përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies dhe teknologjive të reja për të rritur cilësinë e procesit mësimor dhe kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik. UNIKO në faqen web ka vënë në dispozicion Manualet e përdorimit të metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies ( <a href="#">Moodle</a> , <a href="#">eduMEET</a> , <a href="#">Google Meet</a> , <a href="#">Google Classroom</a> , <a href="#">Office 365 for Education</a> , etj). Gjithashtu UNIKO (SPKSHD) ka organizuar trainime të personelit akademik mbi mënyrat e përdorimit të tyre.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.	<p><i>Faqja zyrtare e UNIKO nuk është aktive dhe nuk mund të konfirmohet historiku (kontrolli më i fundit 10 SHkurt 2022.)</i></p> <p>Mbështetur në dokumentacionin bashkëngjitur vihet re se në periudhën e marrë në konsideratë për realizimin e programit të studimit “Matematikë-Informatikë” personeli akademik me kohë të plotë zë pjesën më të madhe të stafit akademik të përfshirë në mësimdhënie. Stafit akademik (me kohë të plotë) që mbulon modulet e programeve të studimit ka shkallë të lartë kualifikimi. Të dhëna për kualifikimin, aktivitetin pedagogjik dhe kërkimin shkencor të stafit akademik për 5 vitet e fundit janë dhënë në <b>Aneksin II.09</b></p> <p>Jetëshkrimet e stafit të përfshirë në programet e studimit. Përveç personelit akademik me kohë të plotë, janë ftuar të kontribuojnë në mësimdhënie profesorë nga Departamenti i Fizikës dhe Departamenti i Matematikës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës, të cilët për më tepër kanë zhvilluar dhe orë të hapura (<b>Aneks III.18</b>) me studentë të programeve të studimit të departamentit të Matematikë-Fizikës.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit**

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Sipas axhendës për këtë qëllim u realizua një vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.) si dhe vizitë në Bibliotekë dhe nga këto vrojtime u vu re se: UNIKO dhe FSHNH ofron një infrastrukturë të plotë fizike, didaktike dhe logjistike, që ndihmon realizimin dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Auditorët mësimorë, laboratorët, ambjentet e personelit akademik dhe ndihmës akademik, si dhe biblioteka janë mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme, për zhvillimin cilësor të veprimtarisë mësimore (<b>Aneks IV.07</b>). Në fillim të çdo semestri hartohet <u>orari mësimor</u> në të cilin detajohen mjediset mësimore ku do të zhvillohen konkretisht leksionet, seminarët, etj., në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën e modulit.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjediset tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Sipas axhendës për këtë qëllim u realizua një vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj) nga këto vrojtime u vu re se: të gjitha lëndët/modulet e këtij programi studimi realizohen pranë mjediseve të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. Të gjithë auditorët në të cilët studentët ndjekin leksionet seminarët dhe labororet janë të pajisura me mjete audiovizive. Mjediset e leksioneve dhe seminarëve kanë siguruar një hapësirë të konsiderueshme për studentët. Auditorët ku realizohen leksionet kanë një kapacitet për rreth 80 vende (140 vende në amfiteatër), ndërsa sallat e seminarëve kanë kapacitet më të vogël, për rreth 35-40 vende. Kështu, studentit i krijohet një mjedis komod dhe i mjaftueshëm për ndjekjen e procesit të mësimdhënies (<b>Aneks IV.07</b>). Duke konsideruar numrin e vogël të studentëve për këto vite akademike në shqyrtim mjediset e ofruara sigurojnë cilësi dhe komoditet për studentin.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Pas vizitës në mjediset e zhvillimit të mësimin dhe laboratore u vu re se programi i studimit Bachelor “Matematikë-Informatikë” shfrytëzon dy laboratorë kryesorë nga (14 që ofron FSHNH). Laboratorët e fizikës me kapacitet 25 dhe 40 vende. Të dy këta laboratorë janë të pajisur me të gjitha pajisjet, mjetet, materialet e nevojshëm për realizimin e objektivave të përcaktuar në secilin modul si dhe me rregulloren e sigurimit teknik (<b>Aneks IV.07; Aneks II.17</b>). Laboratorët e Informatikës ku zhvillohen seminarët e lëndëve të informatikës sigurojnë poste fizike për studentët dhe mjete kompjuterike, tabela, projektor të përshtatshme për aftësimin teorik dhe praktik.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Krahas këtyre laboratorëve studentët që ndjekin këto dy programe studimi shfrytëzojnë edhe 2 laboratorët e informatikës, laboratorë kompjuterikë me kapacitet 25 vende, me programe profesionale për të përmbushur objektivat specifike të moduleve të dy programeve të studimit si dhe të pajisur me videoprojektorë dhe sistem të instaluar fonie. (<b>Aneks IV.07</b>). Programet softuerike që përdoren nga stafi akademik për qëllime të mësimdhënies instalohen në këto kompjutera nga ana e tyre dhe vihen në dispozicion të studentëve edhe për detyra/projekte.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të</p>	

mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	UNIKO ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione homologe prej të cilave po përfitohet në drejtim të shkëmbimit të përvojës, kërkimit shkencor, ristrukturimit të programeve të studimit, përditësimit të kurrikulës, organizimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe kryerjes e praktikave profesionale sidomos për ato programe studimi kurrikula e të cilave përfshin praktikat specifike profesionale . Këto marrveshje gjenden të listuara në <b>Aneks II.10</b> .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Duke iu referuar RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se biblioteka siguron mjediset e duhura në të cilat studentët e ketij programi studimi, kanë mundësi të barabarta për të marrë shërbime si për të studiuar ashtu edhe për të shfrytëzuar literaturën e tyre.  Biblioteka disponon një fond që përbëhet prej rreth 10592 libra e revista, me rreth 1031 tituj. Rreth 1544 libra e revista nga fondi i bibliotekës, ofrohen në gjuhë të huaj (kryesisht në gjuhën angleze, frënge e italiane) dhe rreth 9048 mijë, në gjuhën shqipe, të cilat jepen për shfrytëzim brenda ambienteve të bibliotekës dhe jashtë saj me një afat kohor ( <b>Aneks IV.08</b> ). Nga këto literatura një pjesë e konsiderueshme ishte në ndihmë të studentëve.
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Nga vizita dhe takimi me përfaqësues të bibliotekës së FSHNH si pjesë e Bibliotekës së UK. 2039 studentë dhe 195 pedagogë rezultojnë të regjistruar. Ajo siguron shërbim dhe informacion bibliotekar falas dhe në mënyrë të barabartë për të gjithë përdoruesit e bibliotekës. Biblioteka dixhitale e UK (U-LIBRARY) mundëson akses në EBSCO Publishing Databases, ku stafi akademik dhe studentët mund të regjistrohen (përmes një llogarie unike dhe fjalëkalimi), të përdorin dhe shkarkojnë revista/periodikë/libra/artikuj të dedikuar për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor. Numri i artikujve shkencorë të hedhur në Katalogun Bibliografik të Bibliotekës, nga autorë shqiptarë në gjuhën shqip është 2486, ndërsa në gjuhë të huaj është 150.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.	
<b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime	Studentët kanë në dispozicion tekste mësimore të hartuara nga pedagogë me emër të universiteteve të tjera në vend dhe jashtë vendit. FSHNSH, ka siguruar një numër të konsiderueshëm tekstesh në mbështetje të programeve të studimit. Numri i kopjeve të

nga ana e të gjithë studentëve.	disponueshme, është i mjaftueshëm në raport me numrin e studentëve të regjistruar. ( <b>Aneksi IV.08</b> )			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.	GVJ konstatoi prezencën e librave dhe literaturës ndihmëse fizike, por edhe faktin që studentët kanë akses në shfrytëzimin e kapaciteteve të bibliotekës, pa pagesë duke ofruar edhe platforma online. Studentët dhe stafi i UK-se ka akses në Bibliotekën Dixhitale U-Library nga RASH Biblioteka e FSHNH është në shërbim të përdoruesve nga dita e hënë deri ditën e premte, nga ora 8.00 deri në orën 16.00, oraret e saj janë publike dhe funksionon përmes kartelave të regjistrimit.			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Nga takimi me sekretarinë mësimore si dhe drejtuesit e institucionit sid e h mbështetur në dokumentacionin e ofruar nga RVB u vu në dukje fakti që UNIKO ka nënshkruar marrëveshjen me RASH ( <b>Aneks I.06.1</b> ) me qëllim, menaxhimin gjithëpërfshirës të informacionit për aplikimin dhe mirëmbajtjen e sistemit ESSE3. Si pjesë e këtij projekti, UNIKO garanton sigurimin e informacionit strategjik.  Përmes sekretarisë elektronike ESSE3 administrohet i gjithë informacioni për studentët dhe aktivitetin e tyre (regjistrimi i studentëve në programet e studimit, transferimi i tyre, faturimet, pagesat, menaxhimi i mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave dhe baza e të dhënave të diplomimit ( <b>Aneks I.06</b> )).
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	Nga takimi me stafin akademik dhe sekretarinë mësimore në lidhje me sistemin elektronik ESSE3, u vu në dukje fakti se nëpërmjet këtij sistemi administrohet dokumentacionin e hartuar nga pedagogu në lidhje me vlerësimin e studentëve (vlerësimi i vazhduar dhe provimi përfundimtar). Dokumente të tjera, që informojnë mbi aktivitetin e personelit akademik, përfshijnë formularin e ngarkesës semestrale/vjetore ( <b>Aneks IV.09</b> ) dhe regjistrin e pedagogut ( <b>Aneks IV.10</b> ). Përgatitja e tyre është përgjegjësi e pedagogut dhe monitorimi
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafaj», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

*Durrës*

dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	përgjegjësi e drejtuesit të njësisë bazë dhe grupit të monitorimit në nivel institucional.
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u theksua se sistemi ESSE3 përdoret nga studentët dhe gjithë personeli përmes një llogarie unike dhe fjalëkalimi. Dokumentacioni që siguron informacion me këtë është Manualin e Sistemit Elektronik ESSE3 ( <b>Aneks I.06</b> ). Gjithashtu, ky sistem ka të integruar edhe sistemin e pagesave me bankë të tarifave dhe pagesave për shërbime. Sistemi ESSE3 siguron akses të dedikuar dhe njëkohësisht është i mbrojtur nga ndërhyrjet, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9887, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. UNIKO në përputhje me Ligjin Nr. 9887 ka miratuar Rregulloren për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale ( <b>Aneks I.09</b> ), e cila zbatohet për të gjitha të dhënat e përpunuara nga UNIKO.
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Programi i studimit Bachelor “Matematikë-Informatikë” për menaxhimin e komunikimit interaktiv dhe shkëmbim të informacionit ndarmjet personelit dhe studentëve shfrytëzon disa platforma:
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	<p><b>Aplikacioni Moodle (Anek III.06)</b> është i aksesueshëm nga pedagogë dhe student dhe ka për qëllim të informojë dhe lehtësojë lidhjen mes tyre (çdo pedagog apo student përdor kredencialet me të cilat ata kanë akses në programin dixhital ESSE3).</p> <p><b>Libraria digjitale U-LIBRARY</b>, e cila mundëson aksesim të librave mësimorë, artikujve dhe revistave shkencore, përdorim të platformës e-learning në më shumë se 30 gjuhë të huaja.</p> <p>Aplikacioni <b>eduMEET (Aneks III.06.1)</b> siguron dhe lehtëson komunikimin në formën e audio dhe video konferencave. Paketa <b>Office 365 for education</b>. Aplikacionet e paketës i krijojnë mundësi stafit dhe studentëve të përdorin dhe të kenë akses në çdo kohë dhe vend (nëpërmjet shërbimit të internetit) në platformat më bashkëkohore për didaktikën dhe komunikimin online.</p> <p><b>Sistemi i menaxhimit ESSE3</b> garanton vizibilitetin në kohë reale të informacioneve të hedhura në sistem nga Fakulteti, Departamenti dhe personeli akademik i tij janë të aksesueshme në kohë reale. Sistemi mundëson monitorimin nga organet drejtuese dhe titullarët e institucionit të aktivitetit akademik dhe administrative nëpërmjet raporteve që gjenerohen prej tij.</p> <p>Sipas dokumentacionit dhe takimeve konfirmohet se informacioni për programin e studimit "Matematikë-Informatikë", personelin akademik dhe aktivitete të ndryshme është i publikuar në faqen web të UNIKO, nënfaqja Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane (këtu jepet informacion lidhur me objektivat, organigramën, stafin akademik, departamentet, programet e studimit, infrastrukturën, veprimtari të ndryshme, botime, leksione, njoftime), si dhe tek nënfaqja Programe studimi.</p> <p>I gjithë informacioni në faqen web të UNIKO është në gjuhën shqipe dhe në gjuhën angleze. <i>Ajo që konstatohet është fakti se faqja e</i></p>

	<i>universitetit nuk është e aksesueshme (kontrolli I fundit 10 Shkurt 2022).</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.6

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Si institucion publik i arsimit të lartë, UK funksionon në bazë të parimit të autonomies financiare (sipas Ligjit të Arsimit të Lartë, 80/2015). Statuti i UK (<b>Shtojca 1.1</b>) përcakton sipas ligjit, administrimin e çështjeve financiare. Projekt-buxheti diskutohet në nivel institucioni në përfundim të çdo viti akademik. Pas aprovimit në Senat dhe me kërkesën e tij, bordi i administrimit miraton projekt-buxhetin. Kosto për student paraqitet në <b>Aneksin IV.11</b>, ndërsa të dhënat për të ardhurat dhe realizimi faktik paraqiten në <b>Aneksin IV.12</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Burimet e financimit janë: Buxheti i Shtetit, pagesat e studentëve, të ardhura nga shërbimet e kryera, donacione, dhe të ardhura nga veprimtaria shkencore.</p> <p>Mënyra e përdorimit të fondeve mund të shikohet në Rregulloren e Drejtorisë Financiare dhe të shpërndarjes të së ardhurave (<b>Shtojca 1.8</b>), (<b>Shtojca 1.8.1</b>).</p> <p>Burimet financiare shpërndahen dhe përdoren sipas strukturës së Buxhetit të Shtetit dhe shpërndarja realizohet në dy faza, hartimin dhe miratimin e buxhetit nga granti i pakushtëzuar që akordohet nga MAS dhe buxhetin nga të ardhurat e Universitetit.</p> <p>Mënyra e përdorimit të fondeve (me përjashtim të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit) përcaktohet në Rregulloren Financiare dhe të Shpërndarjes së të Ardhurave të UK, miratuar nga Bordi i Administrimit (<b>Aneks I.08.1</b>)</p> <p>Projekt buxheti afat mesëm (i përcaktuar në Statutin e UK), kryhet në semestrin e dytë të çdo viti, duke mbledhur kërkesat nga njësitë kryesore dhe ndihmëse.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera</p>	<p>Si institucion publik, UK dorëzon pranë MAS dhe Thesarit pasqyrat ekonomike financiare vjetore. Gjithashtu UK i nënshtrohet auditimit të jashtëm nga MAS dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit. (<b>Shtojca 1.15</b>)</p> <p>Sipas RVB, raportet financiare diskutohen në organet kolegjiale të UK: Rektorat, Bord Administrimi dhe Senat.</p> <p>Qëndrueshmëria institucionale garantohet nga Bordi i Administrimit, duke patur hyrje të sigurta jo vetëm nga studentët por edhe nga fondi i MAS.</p>

financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.	Nga takimi me drejtuesin e fakulteti dhe departamentit, GVJ u informua se, UK ka mjetet e nevojshme financiare për realizimin me sukses të procesit mësimor, se edhe në të kaluarën nuk ka pasur probleme në drejtim të mos financimit.			
<b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.	Institucioni në mënyrë periodike raporton në institucionet e tjera për ecurinë financiare. UK dëshmon se garanton qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave.			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.	UK ka marrë masa për garantimin e të ardhurave duke hapur programet profesionale në mënyrë që sigurohet qëndrueshmëria financiare e institucionit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X	

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<b>Standardi V.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me	Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ vlerëson se në përcaktimin e kriterëve pranuese të UK në programin Bachelor në “Matematikë - Fizikë”, institucioni ndjek të njëjtat politika dhe praktika të përcaktuara nga MAS. Procedurat dhe kriteret e pranimit janë në përputhje me politikat e institucionit. Kriteret dhe procedurat e pranimit

legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	janë në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara në legjislacion dhe specifikohen gjithashtu në statutin e UK ( <b>Shtojca 1.1</b> ), rregulloren e FSHNH ( <b>Aneksi II.02</b> ), si dhe në rregulloren e programit të studimit ( <b>Aneksi II.05</b> ).
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Procedurat për hyrjen dhe ndjekjen e programit i referohen dhe respektojnë barazinë dhe të drejtat për çdo student. Të gjitha procedurat e shoqerojnë studentin përgjatë programit. Për programin e studimit “Matematikë- Fizikë” ofrohen kuota për shtetas shqiptarë, shqiptarë etnikë jashtë kufijve shtetërorë dhe shtetas të huaj që plotësojnë kriteret e përcaktuar nga MASR dhe rregullorja e FSHNH pavarësisht gjinisë, moshës, origjinës apo etnisë.
<b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloret përkatëse dhe procesi ndiqet në të gjitha njësitë për miratim (njësi bazë, njësi kryesore, rektorat, senat akademik, MAS). Pranimi i kandidatëve në këtë program studimi bazohet në udhëzimet e MAS si përsa i përket afateve, llojit të programit të studimit, duke qënë se ky është një program i cili diplomon mësues potencialë ashtu edhe për dokumentacionin që nevojitet për regjistrim. Regjistrimi në sekretarinë elektronike ESSE3, garanton barazinë midis studentëve.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.	Transparenca, aksesueshmëria dhe kuptueshmëria e informacioneve që lidhen me programin e studimit në UK dhe në FSHNH, për kandidatët dhe për të gjithë të interesuarit e tjerë për të vazhduar studimet në kete program studimi, bëhen të mundura nëpërmjet kanaleve formale të komunikimit si dhe mjeteve të komunikimit. E gjitha kjo procedurë bazohet në statutin e UK ( <b>Shtojca 1.1</b> ), në rregulloren e FSHNH ( <b>Aneksi II.02</b> ), në rregulloren e programit të studimit ( <b>Aneksi II.05</b> ). Studentët kanë akses në udhërrëfyesin që pasqyron të gjitha informacionet në lidhje me kriteret, procedurat e pranimit, përzgjedhjes, përparimit, transferimit, njohjes së studimeve, etj. ( <b>Aneksi III.11.1</b> ).
<b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.	Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike të pranimit të studentëve hartohen dhe zbatohen në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë dhe akteve nënligjore të MAS.
<b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Kriteret e veçanta të pranimit për përzgjedhjen e kandidatëve përgatiten çdo fillim viti nga departamenti i Matematikës dhe Fizikës për vitet pasardhëse. Këto miratohen më tej nga Senati i UK dhe shpallen me vendim Rektorati duke u vënë në dispozicion të Qendrës së Shërbimeve Arsimore dhe MASR. Për përcaktimin e kriterëve të veçanta të pranimit, Departamenti bazohet tek: (i) profili i shkollës së mesme; (II) nota mesatare e maturantit; (III) mesatarja aritmetike e notave të dy lëndëve kriter si dhe (IV) nevojat e tregut të punës.
	Të gjitha këto procedura janë të pasqyruara edhe në rregulloret përkatëse dhe procesi monitorohet në të gjitha njësitë (njësi bazë, njësi kryesore, rektorat). Çdo shtetas i huaj mund të regjistrohet si student në

	<p>programin e studimit Bachelor në “Matematikë - Fizikë”, bazuar në kriteret e përcaktuara nga MAS, Statuti dhe Rregullorja e Fakultetit.</p> <p>GVJ konstaton se, kandidatët që duan të ndjekin studimet në ciklin e parë Bachelor informohen përpara fillimit të çdo viti akademik në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike që kërkohen për tu regjistruar në këtë program studimi. Veprimtaria “Ditët e informimit të Maturantëve” shërbejnë për informim direkt dhe sa më të plotë të kandidatëve në qarkun e Korçës për programet e studimit që ofrohen nga Departamenti i Matematikës dhe Fizikës. (Dok. Shtesë 3)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Nga takimi me përfaqësues të departamentit, fakultetit si dhe takimi me studentët dhe vizitës në sekretarinë mësimore mbi këtë çështje është Rregullorja e FSHNH - Kreu IV dhe Kreu V ( <b>Aneks II.02</b> ) si dhe Rregulloret përkatëse të programeve të studimit ( <b>Aneks II.05</b> MI seksioni 7) të cilat venë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik dhe kalimit të studentëve nga njëri vit akademik tek tjetri si për shembull: sistemi i vlerësimit, nota minimale kaluese, numri i krediteve të nevojshme për të kaluar vitin, forma e kontrollit të dijeve, sezonet e provimeve, kohëzgjatja e provimeve, procedurat e transferimit, njohjes së krediteve dhe moduleve etj.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.	Në lidhje me procedurat e mësipërme aktive në informim është edhe Sekretaria Mësimore dhe sekretaria e departamentit. Në faqen web të UNIKO, kategoria Studentët, Udhërrëfyes për studentë ( <b>Aneks III.11.1</b> ) gjithashtu ofrojnë informacionin dhe njoftimet që afishohen në ekranet dhe stendat e vendosura në mjediset e Fakultetit.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësi të studentëve në programin e studimit.	Për këtë çështje bazuar në Rregulloren, FSHNH-ja ofron mundësinë e njohjes së krediteve dhe transferimit të studimeve, midis programeve të studimit të të njëjtit cikël studimi brenda vetë universitetit apo universiteteve të tjera. Ekuivalentimi i diplomave si dhe kriteret dhe rregullat e transferimit të studentëve ofrohen përmes sekretarisë mësimore dhe drejtuesit të njësisë bazë. Studentët që aplikojnë për transferimin informohen mbi vendimin e Komisionit të Njohjes dhe Ekuivalentimit nga institucioni, përmes shpalljes së fituesve në stendat informuese të vendosura në ambientet e fakultetit si dhe sekretarisë mësimore, zyrës së informimit dhe orientimit të studentëve dhe drejtuesit të njësisë bazë.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike,	



<p>institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e njohjes të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme, përcaktohen në Rregulloren e FSHNH</p> <p>- Kreu V (Aneks II.02) në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Neni 89 dhe akte të tjera nënligjore. Studentët mund të informohen në lidhje me kriteret e transferimit nga faja web e UNIKO dhe mund të sigurojnë informacione ndihmëse nga Sekretaria Mësimore dhe Përgjegjësi i Departamentit.</p> <p>Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve, me qëllim vazhdimin e studimeve, merret nga Komisioni i Njohjes dhe Ekuivalentimit i Njësisë Bazë.</p> <p>Informacioni mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit “Matematikë-Informatikë” janë të përcaktuara në Rregulloren e FSHNH - Kreu IV, Nenet 55 deri në 60 (Aneks II.02) si dhe në Rregulloren e departamentit – Kreu IV, Neni 37 (Aneks II.03). Format e kontrollit të, mënyrat e vlerësimit të dijës përcaktohen nga çdo pedagog në programin lëndor (Aneks II.08 MI 2020-2021, Aneks II.08 MI 2020-2021). Këto informacione konfirmohen edhe nga takimet me studentët, stafin akademik si dhe dokumentacionit bashkëngjitur.</p> <p>Institucioni nëpërmjet rregullores së departamentit Kreu 26, Neni 1 (Aneks II.03) dhe Rregulloret e programeve të studimit (Aneks II.05 MI, seksioni 14) informon mbi kriteret që duhet të plotësojë një student lidhur me procedurat e provimit të formimit. Departamenti u ofron studentëve të vitit të fundit programin lëndor që do të përfshihen në provim si dhe fondi i pyetjeve për secilën (Aneks II.15 MI).</p> <p>Rregullorja e UNIKO - Kreu VI, Neni 91 (Aneks I.02) përcakton se në përfundim të studimeve studentët pajisen me një diplomë që shoqërohet me suplementin e diplomës. Për t’u informuar në lidhje me procedurat e tërheqjes së diplomës studentët mund t’i drejtohen Sekretarisë Mësimore të FSHNH, por edhe faqes web të UNIKO.</p> <p>Nga takimi me përgjegjësen e departamentit, rezulton se Departamenti i Matematikës dhe Fizikës si njësi bazë përgjegjëse për prgramin e studimit, informon publikun dhe studentët potencialë para fillimit të çdo viti akademik për tërheqjen e kandidatëve potencialë pranë këtij programi, duke ndërmarrë një sërë veprimtarish informuese në platformat online (publikime në rrjete sociale etj) dhe përmes vizitave informuese në shkollat e mesme të përgjithshme dhe profesionale të Qarkut të Korçës. Përmbajtja e këtyre veprimtarive konsiston në informimin e të interesuarve në lidhje me përmbajtjen e programit të studimit, mundësitë që krijon për punësim etj. Nga sa më sipër, GVJ konstaton që kriteret plotësohen, institucioni është i pajisur me strukturat përkatëse si dhe procedurat e rregulluara dhe zbatuara nga strukturat përgjegjëse për këtë program studimi.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Bazuar në RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ vlerëson se studentët informohen në mënyra të ndryshme për strukturën e programit të studimit. Përgjegjësi i departamentit dhe stafi akademik na informuan se informimi i studentëve fillon në javën parë të vitit akademik për studentët e kursit të parë, nëpërmjet takimeve informuese të organizuara nga Përgjegjësi i Departamentit të Matematikës dhe Fizikës dhe pedagogët e programit të studimit ( <b>Aneksi III.11</b> ). Në këto takime studentët njihen me strukturën, organizimin e programit të studimit në përgjithësi dhe të lëndëve që do të zhvillojnë në veçanti si dhe me stafin akademik.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në fillim të çdo viti akademik, njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit, organizon takime informuese dhe të përshtatjes me fakultetin, ndërsa pedagogët e programit informojnë studentët në lidhje me strukturën dhe organizimin e lëndëve që mbulojnë. Gjithashtu bëhet edhe informim përmes udhërfyesit të studentëve, i cili i vihet në dispozicion që në fillim të vitit akademik ( <b>Aneksi III.11.1</b> ).
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Departamenti i Matematikës dhe Fizikës i informon studentët mbi mundësitë e punësimit dhe i orienton ata drejt tregut të punës dhe kjo bëhet nëpërmjet bashkëpunimit me QKA (Qendra e Karrierës dhe Alumni), në fillim të çdo viti akademik. Gjithashtu informohen lidhur me programet e studimit, planin mësimor, lëndët dhe përmbajtjen e tyre në mënyrë të hollësishme në rregulloren e programit të studimit, syllabuset e lëndëve, nëpërmjet takimeve me stafin akademik etj. ( <b>Aneksi II.5</b> ), ( <b>Aneksi II.7.2</b> ), ( <b>Aneksi II.8</b> ).
<b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Institucioni është i pajisur me struktura që krijojnë mundësinë për informimin e studentëve dhe lehtësojnë tranzicionin e tyre drejt tregut të punës. UK informon, orienton dhe këshillon studentët për mundësitë e punësimit. Zyra e Karrierës dhe Alumnit është struktura përgjegjëse që zhvillon dhe drejton procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit, krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët/alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët, alumnit, stafin dhe të tjerë. ( <b>Shtojca I.5</b> ), ( <b>Aneksi III. 20</b> ), ( <b>Aneksi III. 28</b> )
<b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nga takimi me studentët rezulton, se atyre u vihet në dispozicion një informacioni i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Studentët mund marrin informacionin nga pedagogët, përgjegjësi i departamentit dhe mediat sociale.

	Sipas RVB-së sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit ju ofrohet studentëve në kohë dhe me cilësinë e kërkuar nëpërmjet platformave përkatëse si p.sh. ESSE3. Informacioni në lidhje me programin e studimit bëhet i aksesueshëm nga studentët edhe nga publikimet në faqen elektronike zyrtare të UK.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

#### Standardi V.4

**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Bazuar në vizitën në institucion dhe dokumentacionin mbështetës, GVJ konkludon se institucioni disponon të dhëna sipas viteve për studentët që kanë aplikuar, numrin e studentëve që vazhdojnë studimet dhe studentëve të diplomuar në programe. Këto të dhëna ruhen dhe perpunohen nga sekretaria mesimore e Fakultetit. Gjatë tre viteve të fundit, rezultojnë të regjistruar në këtë program studimi 31 studentë, nga këta 31 studentë 14 prej tyre janë të punësuar në përputhje me diplomën e tyre. <b>(Aneksi IV, Tablea 21 dhe 23)</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Nga vizita në sekretarinë mesimore, rezultojnë se për çdo student sekretaria mesimore disponon dosje, të cilat përmbajnë të dhënat që nga rregjistrimi, ndjekja e studimeve deri në përfundim me diplomimin e tyre. GVJ gjatë vizitës në institucion, konsultoi rregjistrat themelor ku çdo student është regjistruar dhe është pajisur me numër matricullimi. Gjithashtu GVJ konsultoi dosje të studentëve të regjistruar, të cilat përmbanin dokumentacionin e duhur dhe të noterizuar, si: listë notash, kontrata, aneks kontrata, deklarata e studentit, dokumenti i identifikimit, diploma e shkollës së mesme, lista e notave dhe fotografi.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Të dhënat statistikore, për programin e studimit, menaxhohen kryesisht nga sekretaria mesimore e Fakultetit. Sipas Rregullores së Sekretarisë <b>(Shtojca 1.10)</b> Sekretaria mesimore çdo vit përgatit të dhëna statistikore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të larguar, të çregjistruar etj, duke përdorur edhe sistemin ESSE3. Statistikat e përgatitura ruhen në formë elektronike dhe hard-copy. Në këtë program studimi siç u pohua edhe gjatë vizitës në sekretarinë mesimore, nuk ka studentë të transferuar apo çregjistruar.
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Nga vizita në sekretarinë mesimore GVJ u informua se, në fund të çdo sezoni provimesh lektori i lëndës depoziton pranë sekretarisë së fakultetit proces verbalin me listën e studentëve dhe notat përkatëse si dhe një evidencë mbi pikët e fituara gjatë vitit në elementët e ndryshëm të kontrollit të dijeve si dhe pikët përfundimtare të marra në provim. Në
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe	

<p>cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>bazë të këtyre të dhënave sekretaria mësimore bën pasqyrimin e notave në regjistrat e arritjeve akademike.</p> <p>Të dhënat statistikore të studentëve të nxjerra nga sekretaria mësimore , menaxhohen dhe ruhen elektronikisht (në sistemin ESSE3 si edhe në dosje fizike nga personat e autorizuar. Të dhënat janë konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. <b>(Shtojca 1.6), (Dok. Shtesë 6)</b></p> <p>Institucioni harton raporte analitike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve. <b>(Ankesi IV)</b>. Në këto raporte analizohet situata aktuale dhe bëhet krahasimi me vitet e kaluara. Qendra e Karrierës dhe Alumnit (QKA) dhe UK publikojnë raportin e tyre <b>(Aneks III.20)</b>, për të analizuar veprimtarinë dhe e qendrës së karrierës dhe alumni.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe takimet me studentët, GVJ vlerëson se studentët janë të përfaqësuar në organet vendimmarrës të UK sipas rregullave ligjore në fuqi (Ligji i arsimit të lartë, 80/2015; Statuti i UK <b>(Shtojca 1.1)</b>). Ata janë anëtarë me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik. UK garanton të drejtën e studentëve për t'u përfshirë në vendimmarrje, këshillim dhe vlerësim të procesit akademik, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në:</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Senatin Akademik dhe në komisione të tjera si</li> <li>• Këshilli i etikës të UK</li> <li>• NJBSC.</li> <li>• Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) dhe ai i Zgjedhjeve në Fakultet (KZF).</li> </ul> <p>Studentët zgjedhin përfaqësuesit e tyre, nëpërmjet një procesi zgjedhor transparent të garantuar nga ligji dhe institucioni. Gjithashtu ato organizohen në Këshilla Studentorë sipas Rregullores së Këshillit Studentor <b>(Shtojca 1.17)</b>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen</p>	<p>Në përputhje me dispozitat ligjore <b>(VKM 41 24.1.2018, Aneksi II.07.1)</b> departamenti ka parashikuar ngarkesën akademike të studentëve për të gjitha programet e studimit si dhe për programin e studimit Bachelor në Matematikë-Informatikë. Programi i studimit parashikon njohjen e studimeve të pjesshme apo të plota të kryera më parë duke u bazuar në ligjin e Arsimit të lartë 80/2015, në urdhëra dhe udhëzime të ndryshme të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. <b>(Aneksi II.03), (Aneksi II.05)</b>.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	Plani mësimor respekton ngarkesën javore në auditor (maksimumi 25 orë në javë / 50 minutëshe) ( <b>Aneksi II.07</b> ) dhe sipas rregullores së programit të studimit, numri total i orëve në auditor varion nga 645 në 750 orë ( <b>Aneksi II.05</b> ).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojnë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Nga takimi me studentët rezulton se institucioni është i hapur ndaj sugjerimeve të studentëve për përmirësimin e programit të studimit. Tërheqja e mendimeve bëhet nga NJBSC në fund të semestrit kur analizohen aftësitë dhe kompetencat e marra gjatë lëndës dhe problemet që janë evidentuar. ( <b>Aneksi III.13</b> ). Gjithashtu, FSHNH realizon çdo fund viti, rishikimin e programit të studimit, nëpërmjet informacionit që mbledh nga pyetësi i studentëve ( <b>Aneksi II.12</b> ), ( <b>Aneksi III.13.2</b> ). Fakulteti në rregulloren e tij ( <b>Aneksi II.02</b> ), ka parashikuar procedurën që siguron ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë këtu mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit, njësisë dhe pedagogut përgjegjës.			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Nga takimi me studentët u vu re lehtësia që ata kanë në shprehjen e opinionit të tyre për çështjet që lidhen me procesin mësimor, etikës në komunikim, ankimimit të rezultatit, reagimit institucional/njësisë/pedagogut, etj ( <b>Aneksi II.02</b> ). Në anekset bashkëngjitur jepet dinformacion i plotë ku pasqyrohet barazia dhe sigurimi i transparencës gjatë vlerësimit dhe kontrollit të dijeve: regjistri i pedagogut, pasqyra e vlerësimit të studentit, dokumentimi i të dhënave në sistemin ESSE3 dhe procedura e ankimimit (e detajuar në Rregulloret e FSHNH). Studentët shprehin opinionet e tyre dhe gjykojnë drejtësinë në procesin e vlerësimit dhe kontrollit nëpërmjet pyetësorëve studentorë dhe procedurës së ankimimit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Bazuar në RVB, vizitën në institucion, takimet me stafin akademik dhe studentët, GVJ vlerëson se institucioni ka kapacitetet dhe infrastrukturën për orientimin dhe informimin e studentëve. Rregullorja e Fakultetit ( <b>Aneksi II.02</b> ) përcakton mënyrat e komunikimit me studentët, duke përfshirë: <ul style="list-style-type: none"> <li>Faqen Web (e cila duhet të riaktivizohet e të jetë funksionale)</li> <li>Takime të drejtpërdrejta me studentët me strukturat apo stafin akademik.</li> <li>Teknologjinë: Google Meet, Google Classroom, Moodle, eduMeet, lejojnë komunikimet e vazhdueshme me studentët.</li> </ul>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të	

Adresa: "Rruga e Durrësit"  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Stendave komunikuese në brendësi të ambjenteve të FSHNH Edhe sekretaria mësimore luan një rol informues për studentët, për notat e marra, apo ecurinë akademike. Këshilli studentor është funksional dhe veprimtaria e tij njihet nga studentët. <b>(Shtojca 1.10), (Shtojca 1.17).</b></li> </ul>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Si pjesë e rëndësishme e zbatimit të politikës institucionale për orintimin e karrierës së studentëve është edhe QKA (zyrë e vendosur brenda KSCK). Kjo qendër ofron shërbime kundrejt studentëve duke synuar përmirësimin e cilësisë së edukimit dhe lidhjen me tregun e punës.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• QKA komunikon programet e studimeve pranë shkollave të larta të rajonit.</li> <li>• Jep mbështetje mbi bursat apo oportunitete të tjera për studentët.</li> <li>• Shërben si urë lidhëse midis tregut të punës dhe studentëve, duke orientuar profilet e studentëve sipas kërkesave të kompanive, për zhvillimin e intershipeve apo praktikave profesionale.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>Gjithashtu, QKA menaxhon edhe rrjetin Alumni, duke krijuar oportunitete edhe për studentët që janë në përfundim të studimeve të tyre, nëpërmjet vendosjes së kontakteve me studentët që kanë përfunduar tashmë studimet e tyre. <b>(Shtojca 1.5), (Aneksi III.20)</b></p> <p>Nga takimi sipas axhendës me përfaqësues të Qendrës së karrierës dhe Alumni u vu theksi në detyrat dhe kontributin e QKA në lidhje me ecurinë e studentëve.</p> <p>QKA menaxhon Rrjetin Alumni, i cili ka në fokus mbarëvajtjen profesionale të studentëve të diplomuar në UK. Ajo krijon kontakte me punëdhënësit potencialë për të promovuar studentët, në kërkim të mundësive të reja të punësimit. QKA mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash lidhur me punësimin e tyre, si rezultat i gjurmimit, e cila përditësohet vazhdimisht. Në faqen Web, UK publikon periodikisht të dhëna mbi studentët e ekselencës, duke promovuar në këtë mënyrë ofertën më të mirë të tij përballë kërkesave të tregut të punës.</p> <p>Studentët e diplomuar (alumni), janë pjesë aktive e veprimtarisë së QKA. Duke nxitur një marrëdhënie të vazhdueshme mes studentëve aktual dhe të diplomuarve në UK, ajo ndihmon në transmetimin e ideve, nismave, inovacionit, bashkëpunimeve midis studentëve për përballjen me tregun e punës.</p> <p>Nga takimi me studentën dhe përfaqësues të institucionit rezultoi se zyra e informimit dhe orientimit të studentit në FSHNH është në funksion të nevojave të studentëve. Ajo orienton studentët e rinj, këshillon dhe asiston studentët për kërkesat e programeve të studimit, për progresin akademik, informon studentët mbi kërkesat dhe pyetjet e tyre, etj. Një tjetër burim informacioni është edhe sekretaria mësimore, autoritetet drejtuese, stafi i akademik informojnë, këshillojnë dhe mbështesin studentët gjatë ciklit të studimeve në FSHNH. Gjithashtu, zyra e informimit dhe orientimit ndaj studentëve është funksionale, duke i garantuar studentëve informacione në kohë reale mbi programet e studimit, progresin akademik, etj. <b>(Aneksi III.11)</b></p>

	Këshilli studentor, ofron shpërndarjen e informacionit në rrjete sociale të ndjekura nga studentët e programeve të studimit ndër të cilët janë edhe ata të programit “Matematikë-Fizikë”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Në ditën e dytë të takimeve patëm mundësinë të takoheshim me përfaqësues të Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor. Nga takimi me ta si dhe konsultimi i dokumentacionit që shoqëron aplikimin rezultoi se bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015, Kreu X, Neni 103 dhe në Statutin e UNIKO, Kreu IX, Neni 73, (referenca <b>Aneks I.01</b> ), UNIKO është përgjegjës për sigurimin e brendshëm të cilësisë në të gjitha njësitë organizative.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Bazuar në RVB dhe takimin me NJSBC, GVJ vlerëson se institucioni është i pajisur me strukturat që garantojnë monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së brendshme duke përfshirë edhe programin Bachelor në “Matematikë - Fizikë”. Institucioni me propozim të Dekanit ngre pranë cdo njësie kryesore me përfaqësim nga cdo njësi bazë dhe studentët, NJSBC në nivel Fakulteti. Veprimtaria e saj është e mirëpërcaktuar në Rregulloren e Brendshme të FSHNH.  Njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është KSKC. Funksioni i kësaj njësie është në përputhje të plotë të misionit të institucionit si dhe rregulloren e saj. ( <b>Shtojca 1.5</b> ). KSKC si strukturë, është e paraparë në Statutin e UK-së ( <b>Shtojca 1.1</b> ), duke ndjekur standardet e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Politika për sigurimin e cilësisë në UK është publike dhe është pjesë e Planit Strategjik të Zhvillimit të UK ( <b>Shtojca 1.3</b> ), ( <b>Shtojca 1.3.1</b> )
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve	Manuali i Cilësisë ( <b>Shtojca 1.16</b> ), përcakton kornizën, strukturat, parimet dhe procedurat e sigurimit të cilësisë në UK. Në manual, përcaktohet Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), si

të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	struktura që bën vlerësimin e brendshëm të cilësisë. Ajo përbëhet nga përfaqësues nga çdo njësi kryesore, SKSC dhe student. <b>(Aneksi IV, Tabela 24)</b> . Pranë çdo njësie kryesore, me propozim të Dekanit, ngrihet një njësi NJSBC. Kjo përcaktohet edhe në rregulloren e Fakultetit <b>(Aneksi II.02)</b> .			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjve përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.	Institucioni arrin të ofrojë realizimin e sigurimit të jashtëm të cilësisë përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, si dhe proceseve të tjera që promovojnë dhe përmirësojnë cilësinë.  Veprimtarinë e saj NJSBC-ja e mbështet në Manualin e Cilësisë UK <b>(Shtojca 1.16)</b> . Në mënyrë periodike NJSBC-ja raporton dhe informon drejtuesit e njësive bazë dhe kryesore dhe përmes tyre të gjithë stafin e UK-së mbi rezultatet e monitorimeve dhe vlerësimeve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen. <b>(Aneksi III.13.2), (Aneksi III.20)</b> . Edhe nga takimet e organizuara nga institucioni del në dukje aktVizimi i tyre me qëllim sigurimin e cilësisë që institucioni ofron.  Këto raporte krahasohen me standardet e cilësisë të parashikuara Manualin e Cilësisë UK. Zbatimi i standardeve të cilësisë nënkupton zbatimin e standardeve akademike, kërkimore, menaxhuese, infrastrukturore, etj me qëllim që të arrihen nivele maksimale në procesin mësimor dhe kërkimor.			
<b>Shkalla e përbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektive formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.	NJSBC-ja vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit. Në funksion të garantimit të cilësisë, rol të rëndësishëm përveç NJSBC-së ka dhe Departamenti i Matematikës dhe Fizikës, si njësi përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në “Matematikë - Informatikë”. <b>(Shtojca 1.5), (Aneksi II.05)</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.	Departamenti në fund të çdo viti akademik bën analizën vjetore të programit të studimit duke reflektuar të gjitha informacionet e mbledhura nga studimi i tregut <b>(Aneksi III.08), (Aneksi III.12)</b> , rezultatet e sondazhit të studentëve dhe opinionet e pedagogëve. <b>(Aneksi III. 13.1), (Aneksi III. 13.2)</b> . Përgjegjësi i Departamentit bën një relacion me ndryshimet <b>(Aneksi II.12)</b> dhe e paraqet për shqyrtim në Dekanat.
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi,	Nga takimi me Dekanin rezultojnë se ndryshimet pasi merren parasysh nga Dekani, ia paraqet Senatit akademik për vendimin final.



instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.	Ndryshimet e miratuara nga Senati, pasqyrohen ne dokumentacionin mësimor. <b>(Aneksi II.07.2)</b> KSCK <b>(Shtojca 1.5)</b> përdor metodologji dhe instrumente vlerësimi për ecurinë e programeve të studimit dhe aktivitetet e tjera akademike. Nga takimet në institucion me sekretarinë mësimore dhe NJSBC rezultoi se, sekretaria mësimore mban të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me arritjet e studentëve dhe të dhëna të ndryshme për to, të tilla si: arritjet e studentëve dhe karakteristika demografike të studentëve. NJSBC në shkallë institucioni informon Senatin e UK lidhur me rezultatet e vlerësimit dhe sugjerimet për përmirësim. NJSBC në shkallë njësie bën të njëjtën gjë me Dekanin. Këto raporte publikohen dhe ruhen pranë Departamentit.			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Referuar RVB-së, GVJ konstaton se raportet e vlerësimit bazohen në krahasimin e rezultateve të pritshme me ato të vlerësimit të konstatuar si dhe në masat e marra për zgjidhjen e problemeve dhe përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë <b>(Aneksi III.20)</b> . Rezultatet nga raportet e vlerësimit përfshijnë tregues të performancës së pedagogëve, rezultatet e mësimnxënies, etj.			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.				
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga UK dhe vizitën në institucion, GVJ konkludon se vlerësimi nga NJSBC bëhet në nivel institucional dhe si i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme, secili nga departamentet përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programet specifike dhe bën analiza të pyetësorve të studentëve si dhe analiza të përgjithshme për programin e studimit. <b>(Aneksi III.13.2), (Aneksi III.17)</b>  Institucioni ndërmerr analiza të vlerësimit të cilësisë në disa drejtime. Kështu ai përdor instrumente të ndryshme për vlerësimin e cilësisë si analiza dhe përpunimi i raporteve dhe proces verbaleve të kontrollit në auditor, kontrollet e natyrave të tjera si dhe raporti vjetor i hartuar nga fakulteti dhe departamenti <b>(Aneksi III.20)</b> .
<b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.	Nga takimi me përgjegjësen e departamentit dhe stafin akademik të programit të studimit, rezultoi se, në nivel njësie bazë, përgjegjësia e departamentit bën verifikimet direkte duke biseduar me pedagogët mbi literaturën, mënyrat e vlerësimit të njohurive e deri tek metodika e

<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>dhënies nga pedagogu. Gjithashtu, verifikohen materialeve idaktike të lëndës që u vihet në dispozicion studentëve, vlerësimi i provimeve me objektivitet dhe në mënyrë të tillë që teza të paraqesë standardin e duhur për cilësinë e diplomës së kërkuar.</p> <p>Në nivel njësie kryesore, Dekani duhet të mbikqyr mbarëvajtjen mësimore, siç e parashikon Statutit i UK <b>(Shtojca 1.1)</b>.</p> <p>Në nivel institucional, KSCK monitoron cilësinë e zbatimit të kurrikulës, dhe raporton në Rektorat mbi rezultatet e monitorimit. <b>(Shtojca 1.5)</b></p> <p>GVJ konstaton se, institucioni përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista me studentët aktualë, me ato të diplomuar (alumni), me personelin akademik, ndihmës akademik e administrativ. <b>(Aneksi III.17.1), (Aneksi III.13)</b>.</p> <p>Nga takimi me përgjegjësen e departamenti dhe dekanin e fakultetit GVJ konstaton se, këto të fundit, nëpërmjet metodave dhe instrumenteve të tërthorta nxjerrin konkluzione lidhur me cilësinë, për të ndikuar më pas në përmbushjen e standardeve të saj. <b>(Aneksi III.08)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmës akademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Në mënyrë periodike UK përdor instrumenta vlerësuese për testuar ecurinë e programeve të studimit. NJSBC organizon modele pyetësorësh drejtuar studentëve, stafit akademik, stafit administrativ/mbështetës, si dhe palëve të interesit dhe harton raportet përkatëse, ku pasqyrohen rezultatet e vlerësimit sipas tematikës së trajtuar dhe sugjerimet për përmirësim. Këto raporte i vihen në dispozicion palëve të interesuara me qëllim përmirësimin e ecurisë së programeve.</p> <p>Në FSHNH, ecuria e programeve të studimit vlerësohet në vijimësi me pjesmarrje nga stafi akademik, sekretaria mësimore duke analizuar tregues të matshëm, si numri i të regjistruarve, shkalla e kalueshmërisë, numri i të diplomuarve, etj., relacionet me shkrim të pedagogëve për të gjitha aspektet e organizimit të mësimdhënies për modulet përkatëse, ku evidentohen problemet e hasura dhe sugjerohen zgjidhje, rezultatet e pyetësorëve të organizura me studentët, raportet e vlerësimit të NJSBC dhe opinionet e studentëve të diplomuar.</p> <p>Një tjetër process i cili do të ndihmojë ndjeshëm ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimit do të jetë edhe vlerësimi i performancës së stafit akademik nga përgjegjësi i njësisë bazë duke filluar në vitin akademik 2020-2021, mbi bazën e kriterëve të përcaktuara tek formulari i vlerësimit të performancës së stafit akademik <b>(Aneksi I.16)</b> dhe në zbatim të Manualit të Cilësisë.</p> <p>Në formulimet e pyetësorëve do të rekomandonim një shkallëzim më të qartë për studentin në lidhje me vlerësimin (për shembull niveli “keq” të zëvendësohet me “dobët” ose të përshkallëzohet me numra; propozojmë gjithashtu që të ri-shikohet në tërësi formulimi i pyetësorit, formatimi i tij me qëllim përfitimin më të qartë të përmirësimeve që mund të bëhen nga pedagogu dhe moduli/lënda).</p>

	Bashkëpunimi me aktorë të jashtëm gjithahstu do të rriste besueshmërinë e vlerësimit përkundrejt stafit dhe studentëve			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	Në Manualin e Cilësisë ( <b>Shtojca 1.16</b> ), rregulloren e FSHNH ( <b>Aneksi II.02</b> ) dhe rregulloren e DKSKC ( <b>Shtojca 1.5</b> ), përcaktohen palët e angazhuara në realizimin e procesit mësimor cilësor. Kështu në UK, pedagogët janë jo vetëm realizues të procesit mësimor, por edhe si një faktor i rëndësishëm për rritjen e nivelit të cilësisë duke u angazhuar në përpunimin e rregulloreve dhe standardeve të ndryshme të cilësisë.  Gjithashtu, përfaqësimi i studentëve është instrument i rëndësishëm që realizohet në mënyra të ndryshme, si tërheqja e mendimit nga këshilltarët akademikë, përfaqësimin e tyre në senat dhe në organe të tjera vendimmarrëse të institucionit.
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palët të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Studentët janë pjesëmarrës edhe në NJSBC ( <b>Aneksi III.04</b> ), ku në rregulloren e kësaj njësie ( <b>Shtojca 1.5</b> ), janë parashikuar detyra konkrete për njësitë, individët, studentët, pedagogët dhe palët të tjera të angazhuara për garantimin e cilësisë së programit të studimit. Kjo rregullore garanton përfshirjen e anëtarëve të personelit akademik si dhe të studentëve.  Përfshirja e aktorëve të brendshëm siguron dhe respekton integritetin akademik si të pedagogëve ashtu edhe të studentëve. Bazuar në RVB, GVJ, konstaton se institucioni, garanton integritetin akademik dhe në praktikën e tyre nuk janë konstatuar raste të diskriminimit, të pabarazisë kundrejt stafit akademik dhe studentëve apo të dallimeve subjektive.
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativë dhe studentët e programit të studimit.	Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativë. Personeli ndihmës akademik kontribuon në mirëmbajtjen e ambienteve mësimore, laboratorike me qëllim sigurimin e cilësisë dhe teknologjisë, sekretaria mësimore kontrobon në informimin në kohë dhe cilësi të studnetëve për nevoja informimi në lidhje me programin e studimit dhe stafin akademik e drejtues.
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo	Nga takimet me studentët dhe stafin drejtues të UK si dhe dokumentacionit bashkëngjitur rezulton se institucioni i kushton

<p>pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>rëndësi përfshirjes dhe aktivizimit të studentëve, si një faktor i rëndësishëm në aspektin e sigurimit të cilësisë. Studentët janë pjesëmarrjes në organe dhe struktura që garantojnë dhe zbatojnë politikat e sigurimit të cilësisë, si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, NJSBC/GVB (në kuadër të sigurimit të cilësisë, akreditimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit); studentët janë të lirë të shprehin opinionet dhe propozimet për problematika të ndeshura gjatë ecurisë së programit të studimit, duke i bërë këto publike në takimet e organizuara me Këshillin studentor; studentët janë pjesëmarrjes aktive në plotësimin e pyetësorëve dhe sondazheve periodike (<b>Aneks III.03, Aneks III.04</b>).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë së proceseve që lidhen me programet e studimit parashikon edhe përfshirjen e palëve të treta të cilat me ekspertizën e tyre mund të japin mendime për përmirësimin e cilësisë së programit. GVJ nga shqyrtimi i RVB konstaton angazhimin e ekspertëve të jashtëm në procesin vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë. Ekspertiza e tyre ka qenë e vlefshme sidomos në përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie, në aspektet e lidhjes së teorisë me praktikën. Mendimi i ekspertëve është tërhequr jo vetëm nëpërmjet angazhimit të tyre në mësimdhënie, por edhe në takime të ndryshme, në leksione të hapura, Work-shope etj. (<b>Aneksi III.21.2</b>).</p> <p>Edhe pse u deklarua se institucioni është bashkëpunon me ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj, vihet re nuk ka përpjekje për të afruar ekspertë të jashtëm që të ndihmojnë me përvojën e tyre në lidhje me programin. Përveç leksioneve të hapura të përmendura më sipër nga kolegë të fakultetit të shkencave të Natyrës, Universiteti i Tiranës. GVJ përsërit rekomandimin për të bashkëpunuar me aktorë të jashtëm në kuadër të rritjes së cilësisë së programit të studimit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			<p><b>X</b></p>	

<p><b>Standardi VI.5</b>  <b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, GVJ konstaton se politikat dhe strategjia në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, janë të rregulluara në politikat dhe strategjinë e zhvillimit të UK dhe të programit të studimit (<b>Shtojca 1.3</b>), (<b>Aneksi II.04</b>). Ndërsa organizimi dhe veprimtaritë gjenden në Statutin e UK (<b>Shtojca 1.1</b>), rregulloren e UK (<b>Shtojca 1.2</b>), Manualin e Cilesise të UK (<b>Shtojca 1.16</b>) dhe rregulloren e fakultetit (<b>Aneksi II.02</b>).</p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë së UK administrohet nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, brenda të cilës funksionon Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni (<b>Aneks III.24</b>).</p> <p>Nga takimet ne institucion, GVJ u informua se institucioni publikon dhe bën transparente rezultatet e vlerësimit të NJBSC në faqen Web UK e cila për momentin nuk është aktive.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Program i transparencës në UK, është i lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore që parashikon neni 7 i ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe shikohet si një nevojë për të rritur shkallen e integritetit të stafit dhe përgjegjshmërinë institucionale të universitetit. Institucioni, analizat dhe raportet e ndryshme në lidhje me cilësinë dhe standardet e mësimdhënies dhe nxënies i shoqëron me plane masash për të përmirësuar problemet e konstatuara (<b>Aneksi III.20</b>).</p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti, ben analiza vjetore për rezultatet e veprimtarive akademike. Ato synojnë realizimin e objektivave të cilësisë, duke arritur përmirësimin dhe duke reflektuar hap pas hapi në zgjidhjen e çdo problemi të konstatuar. Institucioni e vlerëson efektivitetin e programit të lidhur ngushtë me aftësimin e studentëve për të realizuar objektivat dhe pritshmëritë e tyre në përfundim të kursit. Një nga funksionet e vlerësimit të brendshëm të cilësisë është të komunikojë rezultatet dhe të ndërjegjësojë palët e ndryshme të interesit për hapat e ndërmarra për rritjen e cilësisë në të gjitha drejtimet. (<b>Aneksi III.08</b>).</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi mer studentët GVJ u informua se institucioni kryen takime informuese me studentët të të gjitha cikleve, përfshirë edhe ata të këtij programi studimi në funksion të nevojës për plotësimin sa më të mirë të cilësisë, si kusht që diploma dhe njohuritë e tyre të jenë të vlefshme, bashkëkohore dhe afat gjata.</p> <p>Objektiv i rëndësishëm ka qene jo vetëm informimi dhe pjesëmarrja e studentëve dhe pedagogëve në procesin e ndërjegjësimin, por edhe pjesëmarrja e tyre në përmirësimin e cilësisë së programeve të mësimin. (<b>Aneksi III.11</b>), (<b>Aneksi III.11.1</b>).</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Përfundime të vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në  
“Matematikë-Informatikë” ofruar nga Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë**

**Pikat e forta dhe afirmime**


1. Programi i studimit përputhet me profilin dhe fushën e veprimtarisë së institucionit duke qënë në mbështetje të interesave të rajonit të jugut të Shqipërisë për të diplomuar në mësuesi për ciklin e ulët dhe parauniversitar.
2. Personeli akademik i programit të studimit ka kualifikimin e duhur dhe përvojë shumëvjeçare në mësimdhënie.
3. Në funksion të programit, fakulteti disponon laboratore të profilit të matematikës dhe informatikës si dhe logjistikën e nevojshme për zhvillimin e programit mësimor dhe laboratoreve.
4. Institucioni në periudhën e shqyrtuar tregon se ka përpjekje në zhvillimin e politikave të promovimit të programit të studimit në rajon dhe përtej tij (Laboratori i dijes dhe të tjera aktivitete lokale) duke nxitur dhe orientuar studentët drejt profilit të mësuesisë dhe ndihmuar ata të përshtaten në tregun e punës.

**Pika të dobta**

1. Programi i studimit ka mungesë të ngarkesës së praktikës profesionale e cila formon studentin me aftësi profesionale që të mundësojë punësim pas përfundimit të programit bachelor.
2. Vihet re mungesa e marrëveshjeve të bashkëpunimit ku Departamenti përfiton drejtpërsëdrejti në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Një numër i ulët i personelit akademik dhe studentëve ka patur mundësinë të jetë pjesë e projekteve të shkëmbimit në institucione të ngjashme brenda dhe jashtë vendit.

**Rekomandime**

1. Bazuar në gjetjet në përmbajtje të programit të studimit, GVJ rekomandon që në kurrikulën e këtij programi studimi të përfshihet praktika profesionale për të krijuar mundësi punësimi edhe pas përfundimit të programit bachelor dhe të përditësohet dhe pasurohet kurrikula me literatura të kohës.
2. Në ri-organizimin e programit të shihet mundësia e bashkimit të moduleve/ lëndëve në mënyrë që të ulët numri i lartë i provimeve në një vit akademik duke lehtësuar ngarkesë për studentin gjatë sesionit të provimeve.



3. Departamenti të intensifikojë përpjekjet për të lidhur marrveshje bashkëpunimi të drejtpërdrejta ku personeli akademik që kontribuon në ngarkesën mësimore dhe kërkimore të programit të studimit të përfitojë nëpërmjet: mobiliteteve, trajnimeve, projekteve kërkimore shkencore me qëllim nxitjen edhe të rritjes së nivelit mësimor dhe kërkimor në këtë institucion.

### **Conclusions of the Evaluation of the first cycle study program Bachelor in "Mathematics- Informatics" offered by the University "Fan S. Noli", Korça**

#### **Strengths and affirmations**

1. The study program corresponds to the profile and field of activity of the institution being in support of the interests of the southern region of Albania to graduate in teacher for lower and pre-university cycle.
2. The academic staff of the study program has the appropriate qualification and many years of experience in teaching.
3. In function of the program, the faculty has laboratories of mathematics and informatics profile as well as the necessary logistics for the development of the curriculum and laboratories.
4. The institution in the period under review shows that there are efforts in developing policies to promote the study program in the region and beyond (Knowledge Laboratory and other local activities) by encouraging and orienting students towards the teaching profile and helping them to adapt in the labor market.

#### **Weakness**

1. The study program lacks professional practice which forms the student with professional skills to enable employment after the completion of the bachelor program.
2. There is a lack of cooperation agreements where the Department benefits directly in teaching and research. A small number of academic staff and students have had the opportunity to be part of exchange projects in similar institutions at home and abroad.

#### **Recommendation**

1. Based on the findings in the content of the study program, GVJ recommends that the curriculum of this study program include professional practice to create

employment opportunities even after the completion of the bachelor program and to update and enrich the curriculum with literature of the time.

2. In the event of reorganization the program, the institution should see the possibility of merging modules / subjects in order to reduce the high number of exams in an academic year by easing the workload for the student during the exam session.
3. The Department to intensify efforts to conclude direct cooperation agreements where the academic staff that contributes to the teaching and research load of the study program benefit through: mobility, training, scientific research projects in order to promote the increase of teaching and research in this institution.





**SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË CILËSISË SË PROGRAMIT**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				<b>X</b>
<b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>




## REFERENCA

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm

Minutat e takimeve

Aneks I

01 Statuti i UnIversitetit ‘Fan S. Noli’

I.02 Rregullore e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore dhe Kërkimore e UNIKO

I.03 Plani Strategjik i Zhvillimit të UNIKO

I.04 Rregullorja e Drejtorisë Së Burimeve Njerëzore , Komunikimit dhe Promocionit

I.05 Rregullorja e Drejtorisë Së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor I.06

Manual i Sistemit Elektronik ESSE3

I.06.1 Marrëveshje RASH per ESSE3

I.07 Rregullore e Drejtorisë Ekonomike

I.08 Rregullore e Drejtorisë Financiare

I.08.1 Rregullorja Financiare

I.09 Rregullore për Mbrojtjen , Ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale

I.10 Rregullore e Sekretarisë Mësimore të UK

I.11 Rregullore e Senatit Akademik

I.12 Udhëzim për Procedurat e Miratimit, Botimit dhe Shpërndarjes së Teksteve Mësimore në NIVel Njësie Bazë

I.13 Udhëzimi për Rekrutimin e Stafit Akademik

I.14 Udhëzimi për Përmbajtjen e Dosjes së Stafit

I.15 Raport i MASR për Verifikimin e Kapaciteteve Pritëse

I.16 Manuali i Cilësisë UNIKO

I.17 Rregullorja e Këshillit Studentor

I.18 Plotësimi i Rekomandimit për Akreditimin Institucional

I.19 Rregullorja për Organizimin e Zgjedhjeve për Organet dhe Autoritetet Drejtuese

I.20 Kodi i Etikës së UnIversitetit Fan S. Noli 84

I.21 Rregullore e Bordit të Administrimit

I.22 Rregullore për Rregullat dhe Standardet e Përfitimit të së Drejtës për Vitin Akademik Sabatik

I.23 Rregullorja për Parandalimin e Konfliktit te Interesave ne Ushtrimin e Funksioneve Publike

Aneks II Dokumenti

II.01 Vkm Nr. 883, Datë. 04.06.2008

II.01.1 Vkm Nr. 514, Datë. 20.09.2017

II.01.2 Vendimi i Riorganizimit të Fakultetit

II.01.3 Vendimi Nr.65 Datë 21.09.2017

II.02 Rregullorja e Njësisë Kryesore

II.03 Rregullore e Departamentit

II.04 Plani Strategjik për Zhvillimin e Programit të Studimeve

II.05 MI Rregullore e Programit të Studimit MI

II.05 MF Rregullore e Programit të Studimit MF

II.06 MI Diploma, Suplementi Matematikë-Informatikë

Adresa: “Rruga e Durrësit”  
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë  
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

- II.06 MF Diploma, Suplementi Matematikë-Fizikë
- II.06.1 Model Procesverbali
- II.07 MF2018-2019 Planet Mësimore Matematikë-Fizikë 2018-2019
- II.07 Mf2019-2020 Planet Mësimore Matematikë-Fizikë 2019-2020 II.07 Mf2020-2021 Planet Mësimore Matematikë-Fizikë 2020-2021
- II.07 MI2018-2019 Planet Mësimore Matematikë-Informatikë 2018-2019
- II.07 MI2019-2020 Planet Mësimore Matematikë-Informatikë 2019-2020
- II.07 MI2020-2021 Planet Mësimore Matematikë-Informatikë 2020-2021
- II.07.1 Vkm Nr. 41, Datë. 28.01.2018
- II.07.2 MF2018-2019 Kurrikula Matematikë-Fizikë 2018-2019
- II.07.2 MF2019-2020 Kurrikula Matematikë-Fizikë 2019-2020
- II.07.2 MF2020-2021 Kurrikula Matematikë-Fizikë 2020-2021
- II.07.2 MI2018-2019 Kurrikula Matematikë-Informatikë 2018-2019
- II.07.2 MI2019-2020 Kurrikula Matematikë-Informatikë Mi 2019-2020
- II.07.2 MI2020-2021 Kurrikula Matematikë-Informatikë 2020-2021
- II.08 MF2018-2019 Programet Lëndore Matematikë-Fizikë 2018-2019
- II.08 Mf2019-2020 Programet Lëndore Matematikë-Fizikë 2019-2020
- II.08 Mf2020-2021 Programet Lëndore Matematikë-Fizikë 2020-2021
- II.08 Mi2018-2019 Programet Lëndore Matematikë-Informatikë 2018-2019
- II.08 Mi2019-2020 Programet Lëndore Matematikë-Informatikë 2019-2020
- II.08 Mi2020-2021 Programet Lëndore Matematikë-Informatikë 2020-2021
- II.09 Jetëshkrimet E Stafit Akademik që Mbulon Programet e Studimit
- II.10 Lista e Marrëveshjeve Institucionale
- II.11 Vendim për Emërimin e Koordinatorëve të Programeve të Studimit 86
- II.12 Procedura e Ndryshimeve në Planet Mësimore 2021-2022
- II.13 Personeli Akademik dhe Ndihmës Akademik 2020 Fshnh
- II.14 Personeli Sanitar dhe i Mirëmbajtjes
- II.15 Mf Fondi i Pyetjeve për Provimin e Formimit Bachelor “Matematikë-Fizikë”
- II.15 Mi Fondi i Pyetjeve për Provimin e Formimit Bachelor “Matematikë-Informatikë”
- II.16 Formati i Dosjes Mësimore të Stafit
- II.17 Rregullat e Sigurimit Teknik në Laboratorin E Fizikës
- II.18 Training In Microsoft Teams 365
- II.18.1 Trajnimi i Personelit Akademik dhe Ndihmës Akademik për Office 365
- II.19 Model Relacioni për Ndryshime në Programet e Studimit

### Aneks III

- III.01 Mendimi i Dekanit
- III.02 Vendim Rektorati Nr.154, Datë 16.04.2021
- III.02.1 Agjenda Akreditimi
- III.03 Vendimi i Ngritjes së GVB
- III.04 Lista e NJSBC
- III.05 Mobiliteti i Stafit
- III.06 Manual Moodle
- III.06.1 Manual Edumeet
- III.07 UNIKO-Raporti i Vlerësimit të Brendshëm

- III.07.1 Raporti I NJSBC 2019-2020, FSHNH
- III.07.2 Raporti I NJSBC 2018-2019, FSHNH
- III.07.3 Raporti I NJSBC 2017-2018, FSHNH
- III.08 Analiza Vjetore e Departamentit
- III.08.1 Analiza Mësimore Shkencore 2019-2020, FSHNH
- III.08.2 Analiza Mësimore Shkencore 2018-2019, FSHNH
- III.09 Raporti i Analizës Vjetore UNIKO 2019-2020
- III.09.1 Raporti i Analizës Vjetore UNIKO 2018-2019
- III.10 Prezantimi i UNIKO për Maturantët
- III.10.1 Kalendar i Plotë i Takimeve Të Promovimit
- III.10.2 Axhenda, Dita e Hapur për Maturantët UNIKO
- III.11 Model Praktika e Informimit të Studentëve me Programin e Studimit
- III.11.1 Udhërrëfyesi i Studentëve 2020-2021
- III.12 Studim Tregu
- III.13 Pyetësor Studentor 2021
- III.13.1 Raport Pyetësi Për Mësimin Online Dhjetor-Janar 2020-2021
- III.13.2 Analiza e Pyetësorit Studentor
- III.14 Draft-Pakti për UnIversitetin
- III.15 Rreth Tecomp në Erasmus+
- III.16 Katalogu i Studimeve 2019-2020
- III.17 Analiza e Pyetësorit të Fund modulit
- III.17.1 Model Pyetësi Fundmoduli Studimi
- III.18 Shembull I Orëve Të Hapura III.18.1 Orë E Hapur Departamenti I Informatikës
- III.19 Model Programi I Shkurtuar
- III.20 Analiza Qka 88 III.20.1 Ecuria Aktuale E Gjurmimit Të Studentëve Të Diplomuar 2019-2020
- III.20.2 Të Dhëna Për Gjurmimin E Studentëve Të Diplomuar 2018-2019
- III.20.3 Të Dhëna Për Gjurmimin E Studentëve Të Diplomuar 2017-2018
- III.21 Konferenca Raem 2021 III.21.1 Konferenca Raem 2019
- III.21.2 Workshop Raem 2018 III.21.3 Konferenca Didaktika E Shkencave
- III.22 60 Vjetori I Fluturimit Të Parë Në Hapësirë
- III.22.1 Modeli Për Të Dashur Shkencën 1
- III.22.2 Modeli Për Të Dashur Shkencën 2
- III.22.3 Promovimi I Librit Të Prof.Dr. Mimoza Hafizi
- III.23 Laboratori I Dijes III.24 Struktura Dhe Organika UNIKO 2021
- III.25 Propozim Për Ngritjen E Komisioneve Të Provimit Të Formimit
- III.26 Udhëzim Nr. 27, Datë 29.12.2017 III.27 Modele Formulari Vlerësimi I Analizës Së Punës Shkencore
- III.28 AktIViteti“Shija E Pse-Ve”
- III.29 Urdhër I Rektorit Për Kontrollin E Dokumentacionit Mësimor
- III.30 Lista E Projekteve UNIKO 89

#### Aneks IV

#### IV Tabela Përmbledhëse



- IV.01 Tabela Përmbledhëse E Ngarkesës Së Stafit Akademik Për Programet E Studimit, Mf, Mi Për Tre Vitet E Fundit (2018-2019, 2019-2020, 2020-2021)
- IV.02 Tabela Përmbledhëse E Ngarkesës Së Departamentit Për Tre Vitet E Fundit (2018- 2019, 2019-2020, 2020-2021)
- IV.03 Format I Shpalljes Së Vendit Vakant
- IV.04 Vendimi I Rektorit Për Ngritjen E Komisionit Ad Hoc
- IV.05 Model I Kontratës
- IV.06 Format I Urdhër Emërimit
- IV.07 Infrastruktura Në Dispozicion Të Dy Programeve Të Studimit, Mf, Mi
- IV.08 Të Dhëna Mbi Fondin E Librave Në Bibliotekë, Fshnh
- IV.09 Model Formulari Ngarkese Për Tre Vitet E Fundit (2018-2019, 2019-2020, 2020-2021)
- IV.10 Model Regjistri
- IV.11 Të Dhëna Lidhur Me Kosto/Student Për 4 Vitet E Fundit (2016-2017, 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020)
- IV.12 Të Dhëna Lidhur Me Fondet E UNIKO 'Grant I Buxhetit' & 'Të Ardhurat E Krijuara', Dhe Realizimi Faktik Për 4 Vitet E Fundit (2016-2017, 2017-2018, 2018-2019, 2019-2020)

